








UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë  
Bachelor në "Matematikë Informatikë"

### Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Prof.asoc. Dr. Kastriot Zoto (Kryetar) 
2. Prof.asoc. Dr. Krisanthi Naka (Anëtare) 
3. Dr. Dhori Terpo (Anëtar) 
4. Dr. Antuela Sinani (Anëtare) 
5. Daniel Muçenji (Student) (Anëtar) 

Tetor 2023



## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës është pasardhës i Katedrës së Matematikës, një nga katedrat më të vjetra, qysh në vitin 19/1 me themelimin e Institutit të Lartë Pedagogjik të Gjirokastrës, sot Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë.

Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës është përgjegjës për 4(katër) programe studimi: 2(dy) programe të ciklit të parë të studimit Bachelor dhe 2(dy) programe të ciklit të dytë të studimit Master në Mësuesi.

Programi i studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë" me kohëzgjatje 3 vjeçate u hap për herë të parë në vitin akademik 2004-2005 me Vendim të MASH "Mbi hapjen e kursit të ri të studimit Matematikë-Informatikë në Universitetin e Gjirokastrës", Nr. 4280 Prot., datë 01.07.2004.

Ky program studimi në vite ka pësuar ndryshime në funksion të ndryshimeve ligjore dhe kërkesave të tregut të punës. Ai është në përputhje të plotë me kornizën ligjore në fuqi, Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, datë 22.07.2015, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, date 24.01.2018", VKM Nr. 185, datë 25.03.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018", Statutin e UGJ-së dhe Rregulloret Institucionale.

Programi i studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë" që çon drejt marrjes së Diplomës Bachelor në "Matematikë Informatikë", organizohet dhe shprehet përmes grumbullimit të krediteve sipas Sistemit Evropian të Grumbullimit dhe Transferimit të Krediteve (ECTS). Për të fituar këtë diplomë nevojiten 180 kredite (ECTS). 60 kredite (ECTS) përfaqësojnë ngarkesën e punës së një viti akademik studimesh.

Ky program studimi synon:

*Së pari*, një formim bazë në disiplinat Matematikë dhe Informatikë, i cili do të shërbejë për studentet e diplomuar në këtë program studimi qoftë në aspektin e punësimit, qoftë edhe si bazë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në ciklin e dytë dhe të tretë në Matematikë, Informatikë apo programe të tjera përkatëse integruese.

*Së dyti*, në krijimin e mundësive për futjen e informacionit të ri nga Informatika dhe disiplinat aplikative të Matematikës, i cili do ta bëjë kuadrin e ardhshëm të aftë të mbështesë zhvillimet aktuale dhe të perspektivës në arsim, ekonomi dhe biznes.



*Së treti*, do të shërbeje si bazë për përgatitjen e kontigjentit sa më të përgatitur për mësues të shkollave 9-vjecare dhe të mesme me drejtim teknik-shkencor.

*Së katerti*, studentët që do të mbarojnë këtë program studimi, nuk do të fitojnë thjesht njohuri teorike tradicionale mbi këto fusha, por nga vetë struktura e planit mësimor dhe programeve të lëndëve mësimore të parashikuara në të, ata do të fitojnë më tepër njohuri dhe aftësi praktike bashkohore të domosdoshme për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave të tregut të punës.



## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Procesi i vlerësimit të brendshëm për programin e studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” ka nisur me propozim të Njesisë Bazë të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, si njësi përgjegjëse e këtij programi për akreditim. Ky aplikim është kryer nga Koordinatorja Institucionale në sistemin AMS në datën 14.12.2023 dhe është përcjell zyrtarisht pranë ASCAL me shkresën Nr. 1685 Prot. datë 15.12.2022. ASCAL me shkresën Nr. 117/1 Prot., datë 06.03.2023 “Konfirmim i aplikimit për akreditimin e 20 programeve të studimit”, ka konfirmuar aplikimin e UGJ-së dhe nëpërmjet sistemit AMS është dërguar Axhenda e fazës së vlerësimit.

Bazuar në sa më lart, u ngrit Grupi i Vlerësimit të Brendshëm me vendim Nr. 1, datë 03.04.2023 bazuar në propozimin e drejtuesit të Njesisë Bazë të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës me përbërje si më poshtë:

1. Prof.asoc. Dr. Kastriot Zoto (Kryetar)
2. Prof.asoc. Dr. Krisanthi Naka (Anëtare)
3. Dr. Dhori Terpo (Anëtar)
4. Dr. Antuela Sinani (Anëtare)
5. Daniel Muçenji (Student) (Anëtar)

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm mori pjesë në trajnimin me përfaqësuesit e ASCAL të zhvilluar në datën 11.09.2023, ku u njoh me procedurat, dokumentacionin, aspekte dhe këshilla të tjera të nevojshme për realizimin e procesit.

Në hartimin e raportit Grupi i Vlerësimit të Brendshëm ka patur si qëllim të përshkruajë e të nxjerr në pah përmbushjen e standarteve të cilësisë, sipas përcaktimeve të Kodit të Cilësisë miratuar me Vendimin Nr. 824, datë 24.12.2021.

Ky raport është produkt i një procesi gjithëpërfshirës që ka si qëllim sigurimin e një vlerësimi sa më korrekt dhe të matshëm të përmbushjes së standarteve dhe garantimit të cilësisë së programit të studimit.



**Tabela me shkurtime:**

Shkurtimi	Emërtesa
AADF	Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim
AMS	Sistemi i Menaxhimit të ASCAL
ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
DMIF	Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës
DSHNA	Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës akademike Administrative
ECTS	Sistemi Evropian i Grumbullimit dhe Transferimit të Krediteve
FSHN	Fakulteti i Shkencave të Natyrës
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
QSHA	Qendra e Shërbimeve Arsimore
RASH	Rrjeti Akademik Shqiptar
SSCK	Spektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave
UGJ	Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave




*[Handwritten signatures and stamps]*

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Matematikë Informatikë”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti “E.Çabej”, Gjirokastër (UGJ), ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Programet e studimit zhvillojnë, përcjellin dhe mbrojnë dijet përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, formojnë specialist të lartë dhe shkencëtarë të rinj, kontribuojnë në zhvillimin ekonomik social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, kontribuojnë në rritjen e standardeve të demokracisë e qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e studentëve për një shoqëri të tillë. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 2, Neni 4, Neni 5, Neni 8]
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e UGJ-së, të shprehura në Statutin e UGJ-së [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Nenet 4, 5, 8], si dhe në Strategjinë e zhvillimit të UGJ-së. [Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër 2020-2025, Misioni, fq. 8, Vizioni, fq. 8] Edhe programi i studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” [Evidenca I.20 Urdhri i hapjes së Programit të Studimit Bachelor në Matematikë Informatikë] ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e UGJ-së si dhe me fushën e veprimtarisë së tij. Programi i studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” ofron një formim bazë në disiplinat e Matematikës dhe Informatikës i cili do të shërbejë për studentët e diplomuar në këtë program studimi qoftë në aspektin e punësimit, qoftë edhe si bazë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve në Matematikë, Informatikë apo programe të tjera përkatëse integruese. [Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Matematikë Informatikë, Neni 3]
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.	Programi i studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të Strategjisë së zhvillimit të UGJ-së [Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër 2020-2025, Misioni, fq. 8, Vizioni, fq. 8], të Statutit të UGJ-së [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Nenet 62, 63, 65], të Rregullores së UGJ-së [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Nenet 42, 46, 48] si dhe me fushat e drejtimit akademike të UGJ-së. Programi i studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” ofron një formim bazë në disiplinat e Matematikës dhe Informatikës i cili do të shërbejë për studentët e diplomuar në këtë program studimi qoftë në aspektin e punësimit, qoftë edhe si bazë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve në Matematikë, Informatikë apo programe të tjera përkatëse integruese. [Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Matematikë Informatikë, Neni 3].



<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>UGJ është një Institucion i Arsimit të Lartë, themeluar më 1971. [Evidenca I.18 Vendimi i hapjes së ILP-së; Evidenca I.19 Vendimi mbi krijimin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër dhe hapjen e njësisë kryesore FSHN] UGJ ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për ofrimin e programit Bachelor në "Matematikë Informatikë". [Evidenca I.21 Vendim i Akreditimit Institucional periodik]</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë" është program i nivelit 6, sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe është hartuar në përputhje me misionin e UGJ-së.[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Nenet 5, 63] Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë" është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të FSHN-së [Evidenca I.6 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Nenet 2, 5], si dhe me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. [Evidenca I.17 Vendim riorganizimi i Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës në grupe mësimore kërkimore]. Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës (DMIF), bazuar në Nenin 86 të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin Nr. 310, datë 11.05.2022 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" të Këshillit të Ministrave, ka propozuar kodifikimin kombëtar të programit të studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë" dhe është në pritje të aprovimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS).[Evidenca I.22 Përcjellja në MAS e propozimeve për kodifikimin e programeve; Evidenca I.22.1 Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve FSHN]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi I.2</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit, marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda institucionit rregullohen përmes Statutit dhe Rregullores së UGJ-së dhe janë në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Veprimtaria e UGJ-së drejtohet dhe kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese të saj, me kompetenca të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë, në Statutin, në Rregulloren dhe në aktet e brendshme vetërregulluese të institucionit. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu II, III, IV, dhe V; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu II, III, IV dhe V] Veprimtaria akademike, ndihmës akademike dhe administrative-financiare e institucionit, pasqyrohet në raportet vjetore institucionale. [Evidenca I.11 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020; Evidenca I.11.2 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021; Evidenca I.11.4 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022] DMIF për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit siguron</p>

	<p>marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive dhe personelit. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Nenet 10, 47; Evidenca I.14 Organograma e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë; Evidenca I.15 Organograma e Fakultetit të Shkencave të Natyrës; Evidenca I.16 Organograma e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës]</p> <p>DMIF siguron marrëdhënie bashkëpunimi me Departamentet e Fakultetit të Shkencave të Natyrës (Departamentin e Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit dhe Departamentin e Infermierisë), me Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore si dhe me Fakultetin e Ekonomisë. [Evidenca I.29 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik DMIF për vitin akademik 2020-2021; Evidenca I.29.1 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik DMIF për vitin akademik 2021-2022; Evidenca I.29.2 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik DMIF për vitin akademik 2022-2023]</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>UGJ ka të përcaktuar qartë në strategjinë e zhvillimit të tij institucional, prioritetet e politikës së tij të bashkëpunimit. [Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë 2020-2025, Lidhjet komunitare dhe kombëtare fq.31, Roli Ndërkombëtar fq. 32; Evidenca I.3.2 Strategjia e ndërkombëtarizimit]</p> <p>Këto priorite të reflektohen në marrëveshjet e bashkëpunimit me universitete të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe me institucione lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. [Evidenca I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ; Evidenca I.24. Lista e projekteve të UGJ; Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve të UGJ; Evidenca I.26 Leksione të hapura]</p> <p>Nëpërmjet marrëveshjeve, sigurohen marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi ku përfitues janë studentët dhe personeli akademik. Aktivitetet e kryera në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, pasqyrohen edhe në raportet vjetore institucionale. [Evidenca I.11 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020; Evidenca I.11.2 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021; Evidenca I.11.4 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022]</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Programi Bachelor në “Matematikë Informatikë” në planin mësimor nuk përmban zhvillim të praktikës së detyruar profesionale.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>DMIF në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga këto marrëveshje. [Evidenca I.28 Raport projekti TeComp; Evidenca I.28.1 Projekti ICT në mësimdhënie; Evidenca I.28.2 Forcimi i kompetencave të mësimdhënies Kompetencat Didaktike (TeComp)]</p> <p>Marrëdhëniet dhe përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit pasqyrohen edhe në raportet e veprimtarisë mësimore-kërkimore vjetore të DMIF-së. [Evidenca I.13 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në DMIF 2019-2020; Evidenca I.13.1 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në DMIF 2020-2021; Evidenca I.13.2 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në DMIF 2021-2022]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” është një program studimi i ciklit të parë. Forma e studimeve është me kohë të plotë dhe gjuha e mësimdhënies është gjuha shqipe.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” është i organizuar në lëndë mësimore, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program ka kohëzgjatje normale 3(tre) vite akademike dhe një total prej 180 ECTS.</p> <p>[Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 11, pika 1; Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Matematikë Informatikë, Neni 1, Neni 4; Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Matematikë Informatikë 2021-2022]</p> <p>Elementët e programit të studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” janë në përputhje të plotë me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, Vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” dhe Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të Ndryshuar.</p> <p>[Evidenca II.3 VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; Evidenca II.3.1 VKM Nr. 879, datë 18.12.2019; Evidenca II.3.2 VKM Nr. 185, datë 25.03.2021]</p> <p>Në përfundim të këtij programi studimi, studentit i jepet Diplomë Universitare Bachelor në “Matematikë Informatikë”.</p> <p>[Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 11, pika 4; Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Matematikë Informatikë, Neni 4; Evidenca II.5 Model diplome Bachelor në Matematikë Informatikë]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose</p>	<p>Qëllimi i programit të studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” është të ofrojë një formim bazë në fushën e Matematikës dhe Informatikës, i cili do të shërbejë për studentët e diplomuar në këtë program studimi qoftë në aspektin e punësimit, qoftë edhe si bazë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve në Matematikë, Informatikë apo programe të tjera përkatëse integruese.</p> <p>Nëpërmjet veprimtarive formuese të parashikuara në planin mësimor studentët pajisen me njohuri bashkëkohore në fushën e Matematikës dhe Informatikës, të cilat janë të nevojshme për studime më të thelluara në ciklet pasardhëse dhe përbejnë formimin të shprehive të përgjithshme, aftësive dhe kompetencave akademike ose profesionale, të nevojshme për tju përgjigjur sa më mirë kërkesave të tregut të punës.</p> <p>[Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Matematikë Informatikë 2021-2022; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Matematikë Informatikë 2022-2023]</p>

Adresa: Rruga "Studenti"  
Lagja "18 Shtatori", Gjirokaster 6001  
Tel:+355 84263408

E-mail: rektori@uogj.edu.al

Web site: www.uogj.edu.al

<p>profesionale.</p>	<p>Objektivat formuese të këtij programi studimi synojnë:</p> <p><i>Së pari</i>, një formim bazë në disipinat Matematikë dhe Informatikë, i cili do të shërbejë për studentet e diplomuar në këtë program studimi qoftë në aspektin e punësimit, qoftë edhe si bazë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në ciklin e dytë dhe të tretë në Matematikë, Informatikë apo programe të tjera përkatëse Integruese.</p> <p><i>Së dyti</i>, në krijimin e mundësive për futjen e informacionit të ri nga Informatika dhe disipinat aplikative të Matematikës, i cili do ta bëjë kuadrin e ardhshëm të aftë të mbështesë zhvillimet aktuale dhe të perspektivës në arsim, ekonomi dhe biznes.</p> <p><i>Së treti</i>, do të shërbeje si bazë për përgatitjen e kontigjentit sa më të përgatitur për mësues të shkollave 9-veçare dhe të mesme me drejtim teknik-shkencor.</p> <p><i>Së katërti</i>, studentët që do të mbarojnë këtë program studimi, nuk do të fitojnë thjesht njohuri teorike tradicionale mbi këto fusha, por nga vetë struktura e planit mësimor dhe programeve të lëndëve mësimore të parashikuara në të, ata do të fitojnë më tepër njohuri dhe aftësi praktike bashkohore të domosdoshme për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave të tregut të punës.</p> <p>Konkretisht, ata mund të punojnë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Punonjës specialist në sektorin publik ose privat ku do të zgjidhin probleme me karakter matematiko-informatike duke ju përgjigjur më së miri kërkesave të tyre dhe zhvillimeve të sotme në fushën e teknologjisë së informacionit dhe logjistikës së saj.</li> <li>• Me përfundimin e ciklit të dytë Master në Mësuesi, si Mësues të Matematikës në shkollat e mesme dhe 9-veçare.</li> <li>• Me përfundimin e ciklit të dytë Master në Mësuesi, si Mësues të Informatikës në shkollat e mesme dhe në ato 9-veçare.</li> </ul> <p>Dhe <i>së pesti</i>, ky program studimi do të ndihmojë mjaft edhe për të rritur rolin e Universitetit si një qendër e kërkimit shkencor dhe kualifikimit të gjithanshëm në rajon.</p> <p><b>[Evidenca I.9. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Matematikë Informatikë, Neni 3]</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë", mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të Ndryshuar si dhe në Rregulloren e studimeve në UGJ ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese sipas kategorive dhe me ngarkesën përkatëse në kredite:</p> <p>A. Lëndë bazë (35 kredite – 19.44%)  B. Lëndë karakterizuese (96 kredite – 53.33%)  C. Lëndë Ndërdisiplinore/Integruese (23 kredite – 12.77%)  D. Lëndë Plotësuese (18 kredite – 10%)  E. Detyrime Përmblylëse (8 kredite – 4.44%)</p> <p><b>[Evidenca II.3 VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; Evidenca II.3.1 VKM Nr. 879, datë 18.12.2019; Evidenca II.3.2 VKM Nr. 185, datë 25.03.2021; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 23; Evidenca II.9.1 Plani mësimor Bachelor në Matematikë Informatikë 2021-2022; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9)]</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për</p>	<p>Programi Bachelor në "Matematikë Informatikë" në planin mësimor nuk përmban zhvillim të praktikës së detyruar profesionale.</p>

<p>realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” si dhe Rregullorja e Programit të Studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” përcaktojnë qartë detyrimet përmbyllëse.</p> <p>Bazuar në Rregulloren e UGJ, [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 93, pika 1], Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, [Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Neni 38, pika 1, pika 2] dhe Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë”, [Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Matematikë Informatikë, Neni 11, gërma a dhe b] studentët e ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Matematikë Informatikë” diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome që përfaqësojnë 8 kredite 4.44% të numrit total të krediteve.</p> <p>[Evidenca II.9.1 Plani mësimor Bachelor në Matematikë Informatikë 2021-2022; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9)]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzime të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Forma e organizimit të studimeve në programin e studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” është studime me kohë të plotë. [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 8]</p> <p>Rregulloret institucionale dhe Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>[Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 49, Neni 61, Neni 65; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Kreu VI; Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Neni 16; Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Matematikë Informatikë, Neni 9]</p> <p>Format e financimeve të studentëve bazohen në udhëzimet përkatëse dhe aktet nënligjore. Në fillim të çdo viti akademik, realizohen procedurat përkatëse, sipas vendimeve të Bordit të Administrimit UGJ.</p> <p>[Evidenca II.14 Vendime Bordi i Administrimit për bursat dhe mbështetje për kategoritë e veçanta; Evidenca II.14.1 Kategoritë e veçanta që përjashtohen nga tarifat 2019-2020; Evidenca II.14.2 Lista e studentëve me aftësi të kufizuara; Evidenca II.14.3 Vendim Rektorati për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë; Evidenca II.14.4 Vendim Senati për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë; Evidenca II.14.5 Vendim Bordi i Administrimit për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Program i studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” referuar programeve të studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë në Universitetet publike në Shqipëri kanë përmbajtje të ngjashme në masën 70 për qind.</p> <p>[Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë”, Universiteti “A. Xhuvani” Elbasan, <a href="https://uniel.ems.al/school/program/17b37261-8ecf-439f-bc37-a82d00b6cab8.aspx">https://uniel.ems.al/school/program/17b37261-8ecf-439f-bc37-a82d00b6cab8.aspx</a>;</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë”, Universiteti “Fan S. Noli” Korçë <a href="http://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/planet_mesimore_2022/(BA180)%20Matematik%C3%AB-Informatik%C3%AB%20(2021-2022).pdf">http://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/planet_mesimore_2022/(BA180)%20Matematik%C3%AB-Informatik%C3%AB%20(2021-2022).pdf</a>;</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë”, Universiteti “A. Moisiu” Durrës <a href="https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2022/11/M1.pdf">https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2022/11/M1.pdf</a>]</p> <p>Në zbatim të Urdhërit Nr. 225, datë 07.05.2018 të MASR “Për përparimin e përmbajtjes së programeve të studimit në fushën e mësuesisë të institucioneve të arsimit të lartë”, Departamenti i Matematikës Informatikës dhe Fizikës është</p>

Adresa: Rruga "Studenti"  
Lagja "18 Shtatori", Gjirokaster 6001  
Tel:+355 84263408

Web site: [www.uogj.edu.al](http://www.uogj.edu.al)

E-mail: [rektor@uogj.edu.al](mailto:rektor@uogj.edu.al)

	<p>përfaqësuar me anëtarët e tij në grupet e punës sipas profileve të ngritura për rishikimin dhe përafrimin e përmbajtjes së programeve të studimit në fushën e mësuesisë që ofrojnë institucionet e arsimit të lartë dhe janë hartuar nga grupet përkatëse raportet finale për përafrimin e programeve të mësuesisë në masën 80%. Synojmë që në të ardhmen edhe programet e ciklit të parë Bachelor, të së njëjtës fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, të përafrohen dhe unifikohen në masën 80 përqind.</p> <p><b>[Evidenca II.26 Urdhër Nr.225 datë 07.05.2018 MASR; Evidenca II.16 Vendim MAS për përafrimin e përmbajtjes së programeve të studimit në fushën e mësuesisë]</b></p>								
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës bazuar në Nenin 86 të Ligjit Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimin Nr. 310, datë 11.05.2022 “Për Specifikimet dhe Përmbajtjen e Kodifikimit të Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” të Këshillit të Ministrave ka propozuar kodifikimin kombëtar të programit të studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” dhe është në pritje të aprovimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) Më tej do të propozohet dhe kryhet kodifikimi i lëndëve të programit të studimit.</p> <p><b>[Evidenca I.22 Përcjellja në MAS e propozimeve për kodifikimin e programeve; Evidenca I.22.1 Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve FSHN]</b></p>								
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” synon në të ardhmen edhe hartimin e programeve të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe/ose të huaj.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td><b>Nuk përmbushet</b></td> <td><b>Përmbushet pjesërisht</b></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </table>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>				<b>X</b>
<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
			<b>X</b>						

<p><b>Standardi II.2</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, përmbushin detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike, vlerësim dhe akreditim.</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës është hapur me VKM Nr. 414, datë 12.11.1991.</p> <p><b>[Evidenca I.19 Vendimi mbi krijimin e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër dhe hapjen e njësisë kryesore FSHN]</b></p> <p>Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës është riorganizuar me Vendim Senati Akademik, Nr. 31, datë 07.11.2017.</p> <p><b>[Evidenca I.10 Riorganizimi i Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës]</b></p> <p>Programi i Studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” është hapur me Vendim Nr. 4280 Prot., datë 01.07.2004 të MASH.</p> <p><b>[Evidenca I.20. Urdhri i hapjes së Programit të Studimit Bachelor në Matematikë Informatikë]</b></p> <p>Programi i Studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të</p>

	<p>lartë në Republikën e Shqipërisë është riorganizuar sipas vendimeve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendim Senati Akademik të UGJ-së, Nr.16, datë 23.10.2018</li> <li>• Vendim Senati Akademik të UGJ-së, Nr.17, datë 08. 07. 2021</li> </ul> <p>[Evidenca II.7 Vendim Senati Akademik për riorganizimin e planeve mësimore 2018-2019; Evidenca II.9 Vendim Senati Akademik për riorganizimin e planeve mësimore 2021-2022]</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 11; Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Neni 5] përbëhet nga 3(tre) departamente, të cilat, bazuar në Nenin 25 të Ligjit Nr. 80/2015 të Arsimit të lartë, kanë në përbërjen e tyre të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore/tituj akademike, si dhe personel ndihmës akademik. [ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE-(Tabela 1)]</p> <p>Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës [ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE-(Tabela 2)] përbëhet prej 10(dhjetë) anëtarësh personel akademik efektiv nga të cilët 3(tre) mbajnë titullin Prof.asoc.Dr., 3(tre) janë me titullin/gradën shkencore Doc.Dr, 2(dy) janë me gradën shkencore Dr., 2(dy) janë me diplomë universitare Msc., si dhe 1(një) personel ndihmës akademik me karakter mësimor me diplomë universitare Msc.(ekuivalent), duke përbushur në këtë mënyrë kërkesat ligjore për funksionimin e kësaj njësie bazë .</p> <p>Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës [Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Neni 5] është e organizuar në grupe mësimore [Evidenca I.17. Vendim riorganizimi i Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës në grupe mësimore kërkimore] të përbërë nga 5(pesë) anëtarë personel akademik me kohë të plotë .</p> <p>UGJ ka marrë akreditimin periodik institucional me Vendim Nr. 55, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit të ASCAL.</p> <p>[Evidenca I.21 Vendim i Akreditimit Institucional periodik]</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Natyrës/Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” përbush detyrimet e përcaktuara në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 25, pika 4, duke angazhuar 1(një) personel ndihmës akademik me karakter mësimor, për realizimin e punëve laboratorike.</p> <p>[Evidenca I.16 Organograma e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës; Evidenca I.27 Rregullore e punësimit të personelit akademik dhe administrativ, Nenet 7, 8, 9; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE - (Tabela 1 dhe 2)]</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës është i organizuar në grupe mësimore kërkimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Grupi Mësimor Kërkimor i Analizës Matematike, Matematikës së Zbatuar dhe Fizikës</li> <li>- Grupi Mësimor Kërkimor i Algjebër, Gjeometrisë dhe Informatikës</li> </ul> <p>Roli i koordinatorit për programin e studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” mbulohet nga përgjegjësat e grupeve mësimore kërkimore të cilët ndjekin ecurinë dhe zhvillimin e programit sipas grup-lëndëve respektive që mbulojnë dhe raportojnë në mënyrë periodike në Departamentin e Matematikës, Informatikës dhe Fizikës për elementë që lidhen me programin e studimit.</p> <p>[Evidenca II.27 Raport vjetor i aktivitetit të grupit mësimor kërkimor AMzF; Evidenca II.27.1 Raport vjetor i aktivitetit të grupit mësimor kërkimor AGJI]</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: right;">X</p>

<b>Standardi IL3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>FSHIN/DMIF përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë", disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi.</p> <p>Programi i studimit në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", me Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të Ndryshuar, me Statutin e UGJ-së [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 65] si dhe me Rregulloren e Universitetit [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Nenet 48, 66] disponon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregulloren e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës [Evidenca I.7 Rregullore e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës]</li> <li>• Misionin e Programit të Studimi Bachelor në "Matematikë Informatikë" [Evidenca II.17 Misioni i Programit të Studimi Bachelor në Matematikë Informatikë]</li> <li>• Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë" [Evidenca I.9. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Matematikë Informatikë]</li> <li>• Planin mësimor të Programit të Studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë" [Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Matematikë Informatikë 2021-2022]</li> <li>• Programet lëndore (syllabuset) [Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Matematikë Informatikë 2022-2023]</li> <li>• Programin e provimit të përgjithshëm përfundimtar [Evidenca III.11 Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar Bachelor në Matematikë Informatikë]</li> <li>• Modelin e diplomës Bachelor në "Matematikë Informatikë" [Evidenca II.5 Model diplome Bachelor në Matematikë Informatikë]</li> <li>• Suplementin e diplomës [Evidenca II.6.1 Model suplementi i diplomës]</li> <li>• Strukturën mësimore [Evidenca II.29 Struktura Mësimore Bachelor në Matematikë Informatikë]</li> <li>• Personelin akademik të angazhuar në Programin e Studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë" [ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE Cilësia e stafit mësimor nënës për programin e studimit (Tabelat 6)]</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë" përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Format e veprimtarive mësimore, numri i javëve mësimore sipas semestrave, numri total i provimeve sipas semestrave.</li> <li>• Ndarjen e lëndëve mësimore sipas viteve dhe semestrave.</li> </ul>

<p>të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndarjen e lëndëve mësimore sipas aktiviteteve formuese.</li> <li>• Ngarkesën në kredite, numrin total të orëve, numrin e orëve në auditor dhe jashtë auditorit dhe orëve në javë.</li> <li>• Komponentët mësimorë për secilen lëndë</li> <li>• Formën e vlerësimit</li> </ul> <p>[Evidenca II.8 Plani mësimor Bachelor në Matematikë Informatikë 2018-2019; Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Matematikë Informatikë 2021-2022]</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Rregullorja e UGJ-së [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 49, Neni 61, Neni 65], Rregullorja e studimeve në UGJ [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu VI] dhe Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Natyrës [Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Kreu IV] përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> <p>Kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, propozohen nga Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë, Rregullores së UGJ-së, Statutit të UGJ-së, dhe Udhëzimeve të MAS.</p> <p>[Evidenca II.10.1 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2020-2021; Evidenca II.11.1 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2021-2022; Evidenca II.13.3 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2022-2023; Evidenca II.12.1 Kriteret e pranimit të studentëve 2021-2022; Evidenca II.13.1 Kriteret e pranimit të studentëve 2022-2023; Evidenca II.13.4 Vendim Senati Akademik për kuotat 2022-2023 dhe kriteret 2023-2024 Evidenca II.20 Procedurë e transferimit të studentëve]</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminar apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programet lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë" përmbajnë gjithë elementet e nevojshëm në përputhje me formatin e përcaktuar në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" dhe Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të Ndryshuar.</p> <p>[Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Matematikë Informatikë 2021-2022; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Matematikë Informatikë 2022-2023]</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë" është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p> <p>Ndryshimet më të mëdha programi i studimit i ka pësuar me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, bazuar në nenin 71 dhe 73 për organizimin e programeve të studimit.</p> <p>[Evidenca II.7 Vendim Senati Akademik për riorganizimin e planeve mësimore 2018-2019; Evidenca II.9 Vendim Senati Akademik për riorganizimin e planeve mësimore 2021-2022; Evidenca II.7.1 Dërgim në MAS të riorganizimit të planeve mësimore; Evidenca II.7.2 Kthim përgjigje nga MAS për riorganizimin e planeve mësimore]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

**Standardi II.4**

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

**Kriteret****Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Matematikë Informatikë" [Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Matematikë Informatikë 2021-2022; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Matematikë Informatikë 2022-2023] ka të përcaktuar qartë emërtimin, përmbajtjen e veprimtarive, shpërndarjen e lëndëve, duke grupuar lëndët sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Vendimit Nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" dhe Vendimit Nr. 185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, "Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të Ndryshuar, në:

a) Lëndë bazë, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme në fushën e Matematikës dhe Informatikës si: Analizë Matematike 1, Algjebër 1, Gjeometri Analitike dhe Hyrje në Shkencat Kompjuterike.

b) Lëndë karakterizuese që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik në fushën e Matematikës dhe Informatikës si: Analizë Matematike 2, Algjebër 2, Matematike Diskrete, Teori e Numrave, Topologji & Analizë Funktionale, Ekuacione Diferenciale, Kërkime Operacionale, Fizikë, Algoritëm & Strukturë të Dhënash, Programim, Sisteme Operative, Programim OOP & GUI, Bazë të Dhënash.

c) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje si: Arkitekturë dhe Organizim Kompjuteri, Programim Simbolik, Hyrje në Sisteme Programimi, Probabilitet & Statistikë, Analizë Numerike, Kriptografi, Analizë Reale, Rrjete Kompjuterike, Shkrim dhe menaxhim projektsh.

d) Lëndë plotësuese, të fokusuar në përfitim të aftësive në gjuhë të huaj, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive programuese që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës si Gjuhë e Huaj, Programim Java dhe Ndërtim Aplikimesh në Access dhe SQL.

e) Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin e përgjithshëm përfundimtar.

Në përfundim të studimeve ky program i pajis studentët me një formim bazë në fushën e Matematikës dhe Informatikës, i cili do të shërbejë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në ciklin e dytë dhe të tretë në Matematikë, Informatikë apo programe të tjera përkatëse integruese, por edhe në aspektin e punësimit, si specialist i Matematikës dhe Informatikës në sektorin publik ose privat.

[Evidenca II.18 Databazë Alumni; Evidenca II.19 Të dhëna statistike nga Zyra e Alumni; Evidenca II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ, faqe 9; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE - Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23)]

Ky program studimi u jep mundësinë studentëve që të ndjekin studime të mëtejshme në "Masterin në Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Ulët në Matematikë Informatikë" pranë Njësisë bazë të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, por edhe në programe



	<p>studimi të nivelit të dytë apo të tretë në Universitete të tjera publike apo jo publike. [Evidenca II.24 Lista e fituesve Master në Mësuesi për AMU në Matematikë Informatikë 2020-2021; Evidenca II.24.1 Lista e fituesve Master në Mësuesi për AMU në Matematikë Informatikë 2021-2022; Evidenca II.24.2 Lista e fituesve Master në Mësuesi për AMU në Matematikë Informatikë 2022-2023]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Lëndët dhe shpërndarja e tyre në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është bërë duke patur parasysh vështirësinë e konceptimit të tyre, hierarkinë e formimit të koncepteve si dhe ndërvarësinë e lëndëve me njëra tjetrën. Raportet leksion/seminar/laborator, rezultatet e të nxënit, dhe format e kontrollit të dijeve të pasqyruara në programet e lëndëve mundësojnë realizimin e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. [Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Matematikë Informatikë 2021-2022; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Matematikë Informatikë 2022-2023]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë”, është hartuar dhe rishikuar në referencë të programeve të ngjashme kombëtare / ndërkombëtare dhe në bazë të Sistemit Europian të Grumbullimit dhe Transferimit të Krediteve (ECTS). Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, raporti teori praktikë, janë në përputhje me profilin e Programit të Studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë”, i cili i përket fushës së Shkencave Natyrore dhe e përafërt me programe të ngjashme kombëtare / ndërkombëtare. [Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Matematikë Informatikë 2021-2022; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Matematikë Informatikë 2022-2023; Evidenca II.5 Model diplome Bachelor në Matematikë Informatikë; Evidenca II.6.1 Model suplementi i diplomës] Kurrikula e programit të studimeve Bachelor në “Matematikë Informatikë” është organizuar në formë të tillë që studenti të ketë një ngarkesë të njëjtë përgjatë semestrave, mesatarisht 30 kredite për semestër. Raporti i orëve është në pjesën më të madhe 2/2 (2 orë leksion dhe 2 orë seminar) apo 2/1/1 (2 orë leksion 1 orë seminar dhe 1 orë laborator) duke i dhënë rëndësi rritjes së aftësive të studentëve në ushtrimin dhe aplikimin e njohurive teorike të marra në përputhje me profilin e programit. Ngarkesa në kredite për çdo vit akademik është 60 ECTS, një praktikë kjo e njëjtë me programet të ngjashme ndërkombëtare.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Natyrë e lëndëve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike dhe praktike që jep një lëndë në përmbushje të objektivave formuese të programit. Në mënyrë të vazhdueshme, në këtë program studimi, transferohen studentë nga IAL të tjera, publike dhe jopublike ose që e zgjedhin këtë program si program të dytë studimi. [Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Matematikë Informatikë 2021-2022; Evidenca II.20 Procedurë e transferimit të studentëve]. Formimi teoriko-praktik mundëson punësim në përfundim të studimeve. [Evidenca II.18 Databazë Alumni; Evidenca II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni; Evidenca II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21), Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23)]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe</p>	<p>Syllabuset (programet e lëndëve) të programit të studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” përmbajnë të gjitha elementet sipas shtojcës përkatëse të Vendimit Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës,</p>



<p>ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura. Hartimi i programeve lëndore organizohet nga grupet mësimore kërkimore nën drejtimin e Përgjegjësit të grupit mësimor kërkimor, diskutohen dhe miratohen në Departament. [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 19, pika 2/b]</p> <p>Titullari i lëndës depozitoi pranë Njesisë bazë programin lëndor (syllabusin) të nënshkruar prej tij. Para fillimit të lëndës çdo pedagog ju paraqet studentëve syllabusin e lëndës së bashku me modalitetet e përfshira në të për zhvillimin e mësimin.</p> <p>Pjesa e literaturës në çdo syllabus përbëhet nga literatura bazë e detyrueshme dhe literatura e rekomanduar. Botimet e reja të fushave përkatëse të studimit, rezultatet e punës shkencore, integrohen me koncepte në lëndët përkatëse. Literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar synohet të jetë bashkëkohore.</p> <p>[Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Matematikë Informatikë 2022-2023; Evidenca II.22 Miratimi i literaturës bazë në DMIF 2020-2021; Evidenca II.22.1 Miratimi i literaturës bazë në FSHN 2020-2021]</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë", e organizuar me lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, lëndë plotësuese dhe detyrimet përmyllëse, garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, të pasqyruara në çdo program lëndor (syllabuset) në seksionin, "Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit".</p> <p>Rezultatet e të nxënit maten me anë të realizimit të objektivave të lëndës të cilat janë synimet që lënda tenton të arrijë në përfundim të saj, të ndara në njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studenti pritet të përvetësoj në përfundim të lëndës.</p> <p>[Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Matematikë Informatikë 2021-2022; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Matematikë Informatikë 2022-2023]</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë" mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në programet e ciklit të dytë të studimit si "Master në mësuesi për AMU në Matematikë Informatikë" pranë UGJ-së ose Master profesional/Master i Shkencave pranë Universiteteve të tjera publike dhe jopublike.</p> <p>[Evidenca II.24 Lista e fituesve Master në Mësuesi për AMU në Matematikë Informatikë 2020-2021; Evidenca II.24.1 Lista e fituesve Master në Mësuesi për AMU në Matematikë Informatikë 2021-2022; Evidenca II.24.2 Lista e fituesve Master në Mësuesi për AMU në Matematikë Informatikë 2022-2023]</p> <p>Me përfundimin e programit të studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë" studentët fitojnë aftësi dhe kompetenca profesionale për punësimin e tyre në sektorin publik ose privat, në përshtatje me kërkesat e tregut e punës, si specialist Matematike dhe/ose Informatike.</p> <p>[Evidenca II.18 Databazë Alumni; Evidenca II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni Evidenca II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ, faqe 11; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23)]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>



*[Handwritten signatures in blue ink]*

**Standardi II.5**

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Politikat e zhvillimit të Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës rrjedhin nga politikat e zhvillimit të UGJ-së, të cilat janë hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit ekonomik të vendit dhe nevojat e tregut të punës</p> <p>UGJ ka synuar në përshtatjen e programeve të vjetra klasike të studimit në fushën e edukimit (mësuesisë) me nevojat dhe ofertat e tregut të punës, nëpërmjet përmirësimit të kurrikulave mësimore.</p> <p><b>[Evidenca II.30 Vendim Senati Akademik për lëndën Manaxhim projektesh]</b></p> <p>Në përmbajtjen e programeve lëndore të programit Bachelor në “Matematikë Informatikë” personeli akademik ka qenë dhe është në koherencë me Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, e cila është e përqendruar në nxëniet që i përshtaten së ardhmësisë, duke siguruar zhvillimin e njohurive të reja dhe të kompetencave, nxënie që janë thelbësore për karrierat akademike të gjeneratave të reja dhe për jetët e tyre në shoqëri. Kjo ka bërë që studentët në përfundim të programit të studimit në Bachelor në “Matematikë Informatikë”, të jenë në gjendje të zhvillojnë kompetenca të nivelit të lartë në arsimin e reformuar e cila u përshtatet nevojave dhe interesave të tyre, marrëdhëniet e reja me tregun e punës, risive teknologjike, aspiratave të reja njerëzore, si dhe strategjive të reja për zhvillim.</p> <p>Një element shumë i rëndësishëm që shërben për të parë dhe analizuar nevojat e studentëve të diplomuar është dhe angazhimi i personelit të Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës në modulet e trajnimit që kryen në kuadër të projektit “Zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional të mësuesve në Shqipëri (TEAVET-ERASMUS+), [Evidenca II.33 Memorandum IAL dhe MAS për TEAVET; Evidenca II.37 Projekti TEAVET; Evidenca II.35 TEAVET-modulet]</p> <p>Njëkohësisht për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës në bashkëpunim me zyrën e Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar pranë UGJ-së është pjesmarrës dhe promovues të programeve të studimit nëpër eventet e ndryshme të zhvilluara në bashkëpunim me maturanët, studentë dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës, duke ndarë eksperiencat, konsultuar dhe marrë parasysh propozimet e tyre.</p> <p><b>[Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022, Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2023]</b></p> <p>Gjithashtu edhe eksperiencat, njohuritë dhe aftësitë e përfituara nëpërmjet trajnimeve dhe pjesmarrjeve në projekte të personelit akademik të DMIF-së synojnë në përmirësimin e përmbajtjes dhe ecurisë së programeve të studimit që ofrohen.</p> <p><b>[Evidenca II.32 Përfshirja në planet mësimore e materialeve në kuadër të projektit TeComp; Projekt-TeComp, <a href="http://www.tecomp.ni.ac.rs/training-events/">http://www.tecomp.ni.ac.rs/training-events/</a>]</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit</p>	<p>UGJ nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre. Studentët janë të angazhuar në Senatin Akademik të UGJ-së, janë të organizuar në Këshillin Studentor të UGJ dhe kanë Statutin e funksionimit të tyre.</p> <p><b>[Evidenca II.1.1 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik; Evidenca II.25.1 Lista e anëtarëve të Këshillit Studentor; Evidenca 25-Statuti i Këshillit Studentor].</b></p> <p>Nëpërmjet zyrës së Alumni Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, UGJ mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar për përmirësimin e programit të studimit.</p>

të studimit.	[Evidenca II.23 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ, faqe 9]			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	DMIF përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim institucione publike e private [Evidenca II.33 Vendim për lëndën Manaxhim projektsh; Evidenca I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ; Evidenca I.24. Lista e projekteve të UGJ; Evidenca I.25. Lista e mobiliteteve të UGJ] Abonimi prej shumë vitesh, i Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, i mbështetur nga UGJ, në rrjetin zyrtar ndërkombëtar Mathematical Scientific Net [ <a href="https://mathscinet.ams.org/mathscinet">https://mathscinet.ams.org/mathscinet</a> ], i cili është nën kujdesin e Shoqatës Amerikane të Matematikës (AMS), rrjet i cili ofron akses në një bazë të dhënash të mirëmbajtur me kujdes dhe lehtësisht të kërkueshme të rishikimeve, abstrakteve dhe informacioneve bibliografike për pjesën më të madhe të literaturës së shkencave matematikore, ka ndikuar në përmirësimin dhe përditësimin e mësimdhënies në këtë program studimi. [Evidenca II.31 Abonim në rrjetin MathsciNet]			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X


### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Rregullorja e studimeve në UGJ [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 22], Rregullorja e UGJ-së [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 70], Rregullorja e FSHN-së [Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Neni 18, pika 5] përcaktojnë se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale të zhvilluara në auditor, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni të cilat reflektohen në planin mësimor [Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Matematikë Informatikë 2021-2022] si dhe në Programet lëndore (syllabuset) e programit të studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” [Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” 2022-2023] DMIF nuk e ka të përfshirë në programin e studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” praktikën profesionale.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma,	Personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” u përgjigjet më së miri diversitetit dhe nevojave të studentëve duke u ofruar metoda alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit, [Evidenca I.9 Rregullore e Programit të

<p>mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p><b>Studimit Bachelor në Matematikë Informatikë, Neni 6]</b> dhe duke pasur parasysh natyrën e programit të studimit dhe specifikën e çdo lënde të tij, mësimdhënia përfshin përveç metodave didaktike tradicionale, edhe metoda didaktike innovative, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie.</p> <p>[Evidenca III.5 Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të mësimdhënies; Evidenca III.5.1 TeComp-Strategjia për përmirësimin e cilësisë; Evidenca I.28.2 Forcimi i kompetencave të mësimdhënies Kompetencat Didaktike (TeComp); Evidenca III.5.3 TeComp Kompetencat digjitale (përkthyer nga Universiteti i Korçës)]</p> <p>Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, UGJ ofroi alternativën online të mësimdhënies dhe mësimnxënies nëpërmjet platformave elektronike të mësimin në distancë, Classroom, Edumeet, Microsoft Office 365 dhe Microsoft Teams. Për një mësimdhënie sa më efektive UGJ krijoi kushtet e nevojshme për aksesim, të studentëve dhe personelit akademik në këto platforma, nëpërmjet mbështetjes nga personeli IT i Universitetit si dhe ndihmoi me dokumentacionin e nevojshëm teknologjik (manuale) për përdorimin e këtyre platformave.</p> <p>[Evidenca III.1 Urdhër për platformën e mësimin online; Evidenca III.1.1 Implementimi i platformës së mësimin online Classroom; Evidenca III.1.2 Implementimi i platformës së mësimin online Edumeet; Evidenca III.1.3 Implementimi i platformës së mësimin online Office 365; Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik; Evidenca III.1.5 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentet; Evidenca III.1.6 Vendim për format e zhvillimit të procesit mësimor 2020-2021; Evidenca III.1.7 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.8 Vendim Senati për miratimin e rregullores së provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.9 Format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.10 Zhvillimi i sezonit të provimeve FSHN 2020-2021]</p> <p>Gjithashtu Programi i studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” ka të përfshirë në planin mësimor, veprimtaritë formuese “Lëndë me zgjedhje”, veprimtari alternative të kurrikulës që lejon studentin të zgjedhë një lëndë nga një grup lëndësh. [Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Matematikë Informatikë 2021-2022]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>UGJ mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimin të infrastrukturës së mësimdhënies duke ofruar auditor të pajisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies [Evidenca III.2 Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në DMIF]</li> <li>• Modernizimit të bazës laboratorike dhe mbajtjes së saj në gadishmëri për zhvillimin e aspekteve praktike të procesit mësimor [Evidenca III.3 Inventari i mjeteve laboratorike në DMIF]</li> <li>• Krijimit të oportuniteteve për stafin akademik për zhvillimin e kapaciteteve didaktike dhe kërkimore shkencore nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit si dhe pjesëmarrjes në trajnime e workshope në kuadrin e projekteve me partnerë të huaj, për të përsosur metodat e mësimdhënies [Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve të UGJ; Evidenca I.24 Lista e projekteve të UGJ]</li> <li>• Hartimit të udhëzuesve për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme innovative të mësimdhënies. [Evidenca III.5 Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies; Evidenca III.5.1 TeComp-Strategjia për përmirësimin e cilësisë; Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik; Evidenca I.28.2 Forcimi i kompetencave të mësimdhënies Kompetencat Didaktike (TeComp)]; Evidenca III.5.3 TeComp Kompetencat digjitale (përkthyer nga Universiteti i Korçës)]</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorimit të librarive elektronike</li> </ul> <p><b>[Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]</b></p> <p>Edhe gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, në kuadër të zhvillimit të mësimin në distancë (online) në funksion të një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më efektive në UGJ u organizuan trajnime të personelit akademik/ndihmës akademik mbi përdorimin e platformave të mësimdhënies në distancë. <b>[Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik]</b></p> <p>Gjatë periudhës 2017-2020, Universiteti “E. Çabej” Gjirokastrë, ka qenë partner në projektin ndërkombëtar TEAVET. Bazuar në projektin “Zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional të mësuesve në Shqipëri (TEAVET-ERASMUS+), universitetet pjesëmarrëse në projekt patën si qëllim koordinimin ndër-institucional për zhvillimin profesional të mësuesve në sistemin e arsimit parauniversitar, nëpërmjet trajnimeve të mësuesve. Pjesë e këtij projekti kanë qenë dhe personeli akademik nga DMIF. Gjatë këtij angazhimi të zbatimit të projektit me partner brenda dhe jashtë vendit personeli akademik pjesëmarrës, u aftësua për përmirësimin e kompetencave didaktike në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, duke përgatitur dhe module trajnime për zhvillimin e kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional. Këto module të përgatitura edhe nga personeli akademik i DMIF-së u akredituan nga Komisioni i Akreditimit të Programeve/moduleve të Trajnimit (KAPT), në bashkëpunim me Institutin e Zhvillimit të Trajnimeve (sot ASCAP) në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.</p> <p><b>[Evidenca II.33 Memorandum IAL dhe MAS për TEAVET; Evidenca II.34 Projekti TEAVET; Evidenca II.35 TEAVET-modulet]</b></p> <p>Gjatë periudhës 2019-2023 Universiteti “E. Çabej” Gjirokastrë dhe Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës ka qenë “<i>project partner</i>” në projektin ndërkombëtar TeComp (<i>Strengthening Teaching Competences in Higher Education in Natural and Mathematical Sciences</i>) të programit Erasmus+.</p> <p><b>[Faqe zyrtare e Projektit <a href="http://www.tecomp.ni.ac.rs/project-partners/">http://www.tecomp.ni.ac.rs/project-partners/</a>]</b></p> <p>Në kuadër të këtij projekti anëtarë të DMIF-së morën pjesë në trajnime të vazhdueshme për aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies duke përdorur teknologjitë e informacionit dhe komunikimit. Këto trajnime janë kryer si në distancë(online) ashtu dhe me pjesëmarrje fizike në universitetet partnere të cilat pasqyrohen edhe në faqen zyrtare të projektit. <b>[Faqe zyrtare e Projektit <a href="http://www.tecomp.ni.ac.rs/training-events/">http://www.tecomp.ni.ac.rs/training-events/</a>]</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 59, pikat 3, 4, 5, 6, Programi i Studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” përmbush kërkesat ligjore në fuqi përsa i përket kualifikimit të personelit akademik që angazhohet për realizimin e tij. <b>[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE Tabela 6. Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit]</b></p> <p>Aktualisht, për vitin akademik 2022-2023, personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga 6(gjashtë) anëtar personeli akademik efektiv (PAE), 2(dy) anëtar personeli akademik me kontratë (PAK) dhe 1(një) personeli ndihmës akademik me karakter mësimor, të kategorive të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 2(dy) me titullin “Profesor i Asociuar”</li> <li>• 1(një) Lektor me titullin/gradën shkencore “Doc.Dr.”</li> <li>• 1(një) Lektor me gradën shkencore “Dr.”</li> <li>• 4 (katër) Asistent-lektorë me diplomë universitare “Master i Shkencave”</li> <li>• 1(një) personeli ndihmës akademik me karakter mësimor me diplomë universitare “Master i Shkencave”.(ekuivalent)</li> </ul> <p>Niveli dhe lloji i kualifikimit akademik të këtij personeli, është i duhur për shpjegimin e njohurive dhe koncepteve të lëndëve mësimore të programit të studimit, e reflektuar edhe në shpërndarjen e ngarkesës mësimore të personelit akademik.</p> <p><b>[Evidenca III.4 CV-të e Personelit Akademik dhe ndihmës akademik; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Tabela 4. Ngarkesa totale e personelit akademik të</b></p>



	<p><b>programit Bachelor në Matematikë Informatikë në vitin akademik 2022-2023].</b> Personeli akademik i DMIF-së përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studentët mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Metodat që përdoren përgjithësisht sipas tipit të veprimtarisë mësimore janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Leksione: shpjegim i shoqëruar me paraqitje në dërrasë apo në prezantime të tipit "Power point" nëpërmjet videoprojektorëve dhe diskutim interaktiv.</li> <li>• Seminar: diskutim interaktiv në zgjidhjen e ushtrimeve si zbatime të teorisë.</li> <li>• Punë Laboratorike: gjatë së cilës studenti përvetëson dhe provon aftësitë e tij për të eksperimentuar.</li> </ul> <p>Çdo student mbështetet në punën e tij nga këshillat dhe konsulta të vazhdueshme me pedagogun e lëndës gjatë orës së mësimit, ose në orët e konsultimeve të përcaktuara nga secili pedagog brenda orarit zyrtar të punës. Gjithashtu, studentët mund të komunikojnë me pedagogun e lëndës edhe elektronikisht nëpërmjet email-it institucional.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Personeli akademik i DMIF-së, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sygjerimet e tyre.</p> <p>Spektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikolave (SSCK) realizojnë me studentët pyetësorë për vlerësimin e mësimdhënies. Vlerësimet, mendimet dhe sugjerimet e studentëve merren parasysh për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, trajtimit të lëndës, përdorimit të metodave dhe teknologjive bashkohore mësimdhënëse, vlerësimet etj.</p> <p><b>[Evidenca III.6 Procedura për ngritjen e punës dhe zhvillimi i pyetësorit; Evidenca III.7 Analiza e pyetësorëve dhe përcjellja në fakultete]</b></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Bazuar në Statutin e UGJ-së <b>[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 42]</b>, njësitë ndihmëse në funksion të procesit mësimor-kërkimor janë:</p> <p>a. Spektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave</p> <p>b. Spektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë</p> <p>si pjesë përbërëse e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës akademike dhe Administrative, që promovojnë mësimdhënien dhe përmirësimin e vazhdueshëm të saj, koordinojnë dhe bashkërendojnë me Njësitë Kryesore/Bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies, mbështesin zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, <b>[Evidenca III.5 Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies; Evidenca III.5.1 TeComp-Strategjia për përmirësimin e cilësisë]</b>, trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. <b>[Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve të UGJ, Evidenca I.24 Lista e projekteve të UGJ]</b></p> <p>UGJ ka revistën e tij shkencore "Kërkime Universitare" <b>[Evidenca III.14 Periodikët e botuar në UGJ]</b> në format letër dhe në format elektronik, e pajisur me ISSN: 2226-082X, e cila pasqyron botimet më të fundit të Institucionit. <b>[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 84]</b></p> <p>Në UGJ është ngritur dhe funksionon Qendra e të Mësuarit gjatë gjithë Jetës (LLL Centre) e krijuar si produkt i projektit për ngritjen e kapaciteteve TEAVET. <b>[https://teavet.net/]</b> Qendra filloi veprimtarinë në 15.11.2019, në të cilën janë instaluar të gjitha pajisjet dixhitale (të përfituara nga projekti), të nevojshme për procesin e trajnimit. Kjo qendër vazhdon të koordinojë dhe trajnimet e fituara nga Agjencia akredituese UGJ, sipas vendimeve të Komisionit të Akreditimit të Programeve/moduleve të trajnimit. Anëtarë të stafit akademik të DMIF-së janë prej vitesh trajnerë të moduleve të trajnimit ofruar për mësues të arsimit parauniversitar të akredituara nga ASCAP. <b>[Evidenca II.33 Memorandum IAL dhe MAS për TEAVET; Evidenca II.35 TEAVET-modulet]</b></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

**Standardi III.2**

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit, vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregulloren e UGJ-së [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Nenet 68, 81, 82, 83]</li> <li>• Rregulloren e studimeve në UGJ [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Nenet 39, 40, 41, 62, 63, 64]</li> <li>• Rregulloren e FSHN-së [Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Nenet 33, 34, 35, 38,]</li> <li>• Rregulloren e DMIF-së [Evidenca I.7 Rregullore e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, Nenet 30, 31, 32]</li> <li>• Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” [Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Matematikë Informatikë, Nenet 10, 11]</li> <li>• Programet Lëndore [Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Matematikë Informatikë 2022-2023]</li> <li>• si dhe Udhezimet institucionale [Evidenca III.12. Vendim Senati Akademik për miratimin e tezës së provimeve; Evidenca III.8 Marrëveshje bashkëpunimi AADF-UGJ]</li> </ul> <p>Rregulloret e mësipërme janë të publikuara në faqen zyrtare ueb të UGJ-së, ku studentët mund të informohen në lidhje me kriteret e mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e studimeve në UGJ [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 39, pikat 4, 5] modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit u bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor dhe janë të parashikuara në syllabuset e lëndëve nga titullari i lëndës. [Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Matematikë Informatikë 2022-2023]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Rregullorja e UGJ-së, Rregullorja e studimeve në UGJ, Rregullorja e FSHN-së, Rregullorja e Njesisë Bazë të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, por edhe Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” përcaktojnë qartë mënyrat e vlerësimit të studentëve. Në programin lëndor shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor. Vlerësimi i studentit bëhet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit dhe provimi final. Vlerësimi i vazhduar përfaqëson 20% të vlerësimit përfundimtar. [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 39, pikat 5, 6; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Matematikë Informatikë 2022-2023]</p> <p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore në përfundim të lëndës zhvillohet me provim me shkrim. Numri i pyetjeve që përmban një tezë e provimit me shkrim varet nga vëllimi i lëndës, numri i leksioneve dhe seminareve etj. Një tezë e provimit me shkrim përmban pyetje teorike dhe /ose ushtrime që vlerësohen në total me 80 pikë. Për çdo pyetje/ushtrim vihen pikët përkatëse, në varësi të karakterit të pyetjes/ushtrimit. Pyetjet përfshijnë në mënyrë tërësore lëndën përkatëse, duke qenë të formuluar qartë, jo me dykuptime, në mënyrë që studentët të jetë në gjendje të bëjë vetëvlerësimin për përgjigjet që ka shkruar. [Evidenca III.12. Vendim Senati Akademik për miratimin e tezës së provimeve; Evidenca III.12.1 Model i unifikuar i tezës së provimeve; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej”</p>



	<p><b>Gjirokastrë, Kreu V, Nenet 39, 40, 44; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Matematikë Informatikë 2022-2023]</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Personeli akademik i DMIF-së, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre</p> <p>Spektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave (SSCK) realizojnë me studentët pyetësorë për vlerësimin e mësimdhënies. Vlerësimet, mendimet dhe sugjerimet e studentëve merren parasysh për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, trajtimit të lëndës, përdorimit të metodave dhe teknologjive bashkëkohore mësimdhënëse, vlerësimet etj.</p> <p><b>[Evidenca III.6 Procedura për ngritjen e punës dhe zhvillimi i pyetësorit; Evidenca III.7 Analiza e pyetësorëve dhe përcjellja në fakultete]</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>UGJ mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimin të infrastrukturës së mësimdhënies duke ofruar auditor të pajisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies [Evidenca III.2. Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në DMIF]</li> <li>• Modernizimit të bazës laboratorike dhe mbajtjes së saj në gadishmëri për zhvillimin e aspekteve praktike të procesit mësimor [Evidenca III.3 Inventari i mjeteve laboratorike në DMIF]</li> <li>• Krijimit të oportuniteteve për stafin akademik për zhvillimin e kapaciteteve didaktike dhe kërkimore shkencore nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit si dhe pjesëmarrjes në trajnime e workshope në kuadrin e projekteve me partnerë të huaj, për të përsosur metodat e mësimdhënies [Evidenca I.25 Lista e mobiliteteve; Evidenca I.24 Lista e projekteve]</li> <li>• Hartimit të udhëzuesve për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies [Evidenca III.5 Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies; Evidenca III.5.1 TeComp-Strategjia për përmirësimin e cilësisë; Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik; Evidenca I.28.2 Forcimi i kompetencave të mësimdhënies Kompetencat Didaktike (TeComp); Evidenca III.5.3 TeComp Kompetencat digjitale (përkthyer nga Universiteti i Korçës)]</li> <li>• Përdorimit të librarive elektronike [Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]</li> </ul> <p>Në programin lëndor të secilës prej lëndëve evidentohen dhe format e metodat e mësimdhënies të cilat inkurajojnë sensin e autonomisë së studentit [Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Matematikë Informatikë 2022-2023]</p> <p>Në fokus të procesit mësimor është angazhimi i studentëve nëpërmjet ushtrimeve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, literaturës së rekomanduar, artikujve shkencorë të dhënë për t'u studiuar në mënyrë të pavarur etj., të cilat nxitin në mënyrë të vazhdueshme autonominë dhe mendimin kritik të studentëve Përgjatë kohës së punës për këto detyra, studentit mbështetet me udhëzime dhe orientime prej pedagogut të lëndës, si nëpërmjet komunikimit të drejtëpërdrejtë gjatë orës së mësimi apo gjatë orarit zyrtar me studentin, por edhe nëpërmjet komunikimit elektronik përmes postës elektronike institucionale të pedagogut dhe studentëve. Këto forma dhe metoda të mësimdhënies, mbështetur në këto mënyra të komunikimit, ndihmojnë në ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre si dhe duke respektuar rregullat dhe etikën profesionale. [Evidenca III.9 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës]</p> <p>Njëkohësisht në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në "Matematikë</p>



	<p>Informatikë” për çdo lëndë parashikohen dhe orët e studimit individual të lëndës.</p> <p>Nje sfidë e veçantë ka qenë zhvillimi i procesit mësimor gjatë periudhës së pandemisë. Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 mësimdhënia është zhvilluar nëpërmjet platformave elektronike të mësimi në distancë, Classroom, Edumeet, Microsoft Office 365 dhe Microsoft Teams. Për një mësimdhënie sa më efektive UGJ krijoi kushtet e nevojshme për aksesin nga ana e studentëve dhe personeli akademik në këto platforma nëpërmjet mbështetjes nga personeli IT i universitetit si dhe ndihmoi me dokumentacionin e nevojshëm teknologjik për përdorimin e këtyre platformave.</p> <p>[Evidenca III.1 Urdhër për platformën e mësimi online; Evidenca III.1.1 Implementimi i platformës së mësimi online Classroom; Evidenca III.1.2 Implementimi i platformës së mësimi online Edumeet; Evidenca III.1.3 Implementimi i platformës së mësimi online Office 365; Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik; Evidenca III.1.5 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentet; Evidenca III.1.6 Vendim për format e zhvillimit të procesit mësimor 2020-2021; Evidenca III.1.7 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.8 Vendim Senati për miratimin e rregullores së provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.9 Format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.10 Zhvillimi i sezonit të provimeve FSHN 2020-2021]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Rregullorja e studimeve në UGJ [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Kreu V], Rregullorja e FSHN-së [Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Kreu VI], por edhe Rregullorja e programit të studimit të Bachelor në “Matematikë Informatikë” [Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Matematikë Informatikë, Nenet 8, 10, 11] përcaktojnë qartë mënyrat e vlerësimit të studentëve.</p> <p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar i cili bëhet me notë. Shkalla e përvetësimit të programit lëndor vlerësohet me sistemin prej 10(dhjetë) notash. Nota më e ulët për kalimin në një lëndë është nota 5(pesë). Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit konvertohet në notë. Personeli akademik në programin lëndor shpreh modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor.</p> <p>Bazuar në Rregulloren e studimeve në UGJ [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni.39, pika 5] dhe në programin e lëndës [Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Matematikë Informatikë 2022-2023] vlerësimi përfundimtar i studentit përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit i cili përbën 20 % të vlerësimit përfundimtar</li> <li>• Vlerësimi në provim i cili përbën 80 % të vlerësimit përfundimtar [Evidenca III.12.1 Model i unifikuar i tezes se provimeve]</li> </ul> <p>Bazuar në Rregulloren e UGJ [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 81, pika 1] në përfundim të procesit mësimor (në orën e fundit të mësimi) çdo pedagog që është përgjegjës lënde u komunikoi studentëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fitimin ose jo të së drejtës për tu futur në provimin e lëndës përkatëse.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rezultatit e vlerësimit të vazhduar.</li> </ul> <p>Llogaritja e Vlerësimit përfundimtar bëhet sipas përcaktimeve në Rregulloren e Universitetit [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrër, Neni 89]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>UGJ zbaton prej disa vitesh edhe sistemin e automatizuar të korrigjimit të provimeve, në sajë të projektit CLEANSCORE të financuar nga AADF.</p> <p>Studenti është i njohur me metodologjinë e zhvillimit të provimit gjatë procesit mësimor. Personeli akademik asistohet nga koordinatori i AADF pranë Universitetit të Gjirokastrës, për korrigjimin e provimeve me këtë sistem elektronik. [Evidenca III.8 Marrëveshje bashkëpunimi AADF-UGJ].</p> <p>Gjatë periudhës së pandemisë “Covid 19”, në kohën e mësimi “online”, UGJ ka implementuar testimin përmes platformës elektronike Microsoft Teams, duke garantuar shpejtësi, transparencë, objektivitet dhe informim të menjëhershëm/të shpejtë të vlerësimit për studentët. Kjo është zbatuar dhe në programin Bachelor në “Matematikë Informatikë” duke kryer me sukses dhe transparencë të plotë vlerësimin e studentëve. Personeli akademik i DMIF-së ka marrë pjesë në trajnimet e organizuar nga UGJ për hartimin e tezës elektronike të provimit, shfaqjen e rezultateve, planifikimin e orarit të provimit online, etj. nëpërmjet platformës Microsoft Teams për të siguruar mbarëvajtjen e provimit (online).</p> <p>[Evidenca III.1.7 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.8 Vendim Senati për miratimin e rregullores së provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.9 Format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.10 Zhvillimi i sezonit të provimeve FSHN 2020-2021]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e studimeve në UGJ [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrër, Neni 39] dhe në programin e lëndës [Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Matematikë Informatikë 2022-2023] vlerësimi përfundimtar i studentit përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit, i cili përbën 20 % të vlerësimit përfundimtar</li> <li>• Vlerësimi në provim i cili përbën 80 % të vlerësimit përfundimtar [Evidenca III.12.1 Model i unifikuar i tezës së provimeve]</li> </ul> <p>Bazuar në Rregulloren e UGJ [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrër, Neni 81, pika 1] në përfundim të procesit mësimor (në orën e fundit të mësimi) çdo pedagog që është përgjegjës lënde u komunikon studentëve :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fitimin ose jo të së drejtës për tu futur në provimin e lëndës përkatëse</li> <li>• Rezultatit e vlerësimit të vazhduar</li> </ul> <p>Llogaritja e Vlerësimit përfundimtar bëhet sipas përcaktimeve në Rregulloren e Universitetit [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrër, Neni 89]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve kryhet nëpërmjet fazave të ndryshme të kontrollit gjatë semestrit (teste, provimi i ndërmjetëm, punë laborator, detyrë kursi, provim final).</p> <p>Korrigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimit.</p> <p>Njohja me rezultatet paraprake të provimit u bëhet me dije studentëve nëpërmjet publikimit online në librezën e tyre elektronike (në sistemin ESSE3, tashmë në sistemin Pitagora) ose pranë DMIF-së brenda 6 diteve nga data e zhvillimit të tij [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrër, Neni 90].</p> <p>Pas shpalljes së rezultateve, studentëve u jepet e drejta që të rishikojnë individualisht tezat e korrigjura prej pedagogut, duke parë në këtë mënyrë vlerësimin për secilin përgjigje të tyre (të shoqëruara me komente / feedback, këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen) dhe të paraqesin ankesat e tyre eventuale në lidhje me vlerësimin nga ana e pedagogut. Kjo e drejtë e studentëve garantohet në Rregulloren e studimeve në UGJ [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrër, Neni 45]. Deri 8 (tete) ditë nga data e zhvillimit të provimit pedagogu gjeneron, publikon online dhe dorëzon në sekretarinë</p>

	<p>mësimore pasqyrën e rezultateve përfundimtare të provimit në rastet kur nuk ka proces ankimi për rezultatin e provimit nga studenti.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Personeli akademik i DMIF-së ndjekin rregulla strikte për të evituar çdo formë të plagjiaturës apo kopjimit në provime dhe detyra, për studentët që frekuentojnë programin e studimit. Ata ndjekin dhe zbatojnë rregullat e provimeve të përcaktuara në Rregulloren e studimeve në UGJ [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 44, pikat 9, 10], në Rregulloren e UGJ-së [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Nenet 86, 87, 88] në Kodin e Etikës [Evidenca III.10 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës, Nenet 23, 24] dhe në syllabuset e çdo lënde nëpërmjet “Vërejtjeve përfundimtare nga pedagogu i lëndës”, hapësira ku pedagogu parashtron mendime, rekomandime, vërejtje, kufizime, rezerva që lidhen me zhvillimin e lëndës në fjalë gjatë vitit akademik.</p> <p>[Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Matematikë Informatikë 2022-2023]</p> <p>Studentët, janë të detyruar të respektojnë dispozitat e Kodit të Etikës së Universitetit “E.Çabej” Gjirokastër, për atë kohë sa gëzojnë statusin e studentit në këtë Universitet, përfshirë këtu edhe dispozitat që parashikojnë sjelljen e tyre (mos kopjimi, mos mashtrimi gjatë procesit mësimor, plagjiaturat e çdo forme, etj.). [Evidenca III.10 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës, Nenet 25, 26]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>UGJ u garanton studentëve të drejtën për vlerësimin dhe marrjen e rezultateve të kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale që bazohen mbi meritë [Evidenca III.10 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës, Neni 8, pika 2].</p> <p>Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Vlerësimi përfundimtar përbëhet nga vlerësimi i vazhduar dhe vlerësimi në provim. Vlerësimi i vazhduar u jepet studentëve në përfundim të procesit mësimor. [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 81, pikat 1].</p> <p>Teza e provimit, bazuar në Rregulloren e UGJ-së [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 83, pikat 1, 2], përmban pyetje që përfshijnë në mënyrë tërësore lëndën përkatëse, dhe për çdo pyetje/ushtim paraqiten pikët përkatëse.</p> <p>Provimi i lëndës zhvillohet me sekretim. Përgjegjës për sekretimin e fletoreve është Përgjegjësi i departamentit ose një person i autorizuar prej tij. Sekretimi bëhet në prani të komisionit. [Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Neni 34, pika 6]. Rezultatet e vlerësimit përfundimtar jepen në kohë sipas procedurës së parashikuar në Rregulloren e UGJ-së [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 90], në Rregulloren e FSHN-së [Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Neni 34, pika 16] dhe në Rregulloren e DMIF-së [Evidenca I.7 Rregullore e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, Neni 31, pika 16]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studentët në Universitetin “E.Çabej” Gjirokastër, gëzojnë të drejtën të njihen me vlerësimin dhe kërkesën për rishikim të vlerësimit për të gjitha format e kontrollit të dijeve të përcaktuara në syllabusin e lëndës përpara se ky vlerësim të marrë formën përfundimtare dhe njëkohësisht në raste paqartësish, ata kanë të drejtë të rishikojnë personalisht tezën e korrigjuar në prezencë të komisionit të provimit, për të marrë sqarimet e duhura. [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 90; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Nenet 45, 46]</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimi, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e</p>	<p>Çdo kërkesë, ankimi në lidhje me saktësinë dhe korrektësinë e vlerësimit të dijeve nëpërmjet të gjitha formave të kontrollit, të bëra prezant prej studentëve, parashikohet qartë në Rregulloren e studimeve në UGJ [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 46].</p> <p>Ankesa bëhet me shkrim brenda afatit të ankimit dhe i drejtohet Dekanit të Fakultetit. Ai përcakton nëse kërkesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Në</p>

përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	rast se vërtetohen praktika që bien ndesh me Rregulloren atëherë me propozim të Përgjegjësit të Departamentit, Dekani vendos për ndryshimin e komisionit të provimit dhe rihënien e provimit. [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë , Neni 46, pika 2]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi III.4


Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë" është organizuar në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve në fushën e Matematikës dhe Informatikës.</p> <p>Veprimtarive formuese të Programit të studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë", në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" dhe Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të Ndryshuar. [Evidenca II.3 VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; Evidenca II.3.1 VKM Nr. 879, datë 18.12.2019; Evidenca II.3.2 VKM Nr. 185, datë 25.03.2021] grupohen në kategoritë e mëposhtme:</p> <p>a) Lëndë bazë, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme në fushën e Matematikës dhe Informatikës si: Analizë Matematike 1, Algjebër 1, Gjeometri Analitike dhe Hyrje në Shkencat Kompjuterike, (35 kredite).</p> <p>b) Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik në fushën e Matematikës dhe Informatikës si: Analizë Matematike 2, Algjebër 2, Matematike Diskrete, Teori e Numrave, Topologji &amp; Analizë Funksionale, Ekuacione Diferenciale, Kërkime Operacionale, Fizikë, Algoritëm &amp; Strukturë të Dhënash, Programim, Sisteme Operative, Programim OOP &amp; GUI, Bazë të Dhënash, (96 kredite).</p> <p>c) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje si: Arkitekturë dhe Organizim Kompjuteri, Programim Simbolik, Hyrje në Sisteme Programimi, Probabilitet &amp; Statistikë, Analizë Numerike, Kriptografi, Analizë Reale, Rrjete Kompjuterike, Shkrim dhe menaxhim projektsh, (23 kredite).</p> <p>d) Lëndë plotësuese, të fokusuar në përfundimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive programuese që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës si Gjuhë e Huaj, Programim Java dhe Ndërtim Aplikimesh në Access dhe SQL, (18 kredite).</p> <p>e) Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar, (8 kredite).</p> <p>Veprimtaritë formuese, që karakterizojnë këtë program studimi, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në: mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore), studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektsh, përgatitje provimesh, përgatitje e tezës së diplomës, etj.)</p>

	<p>I gjithë programi zhvillohet në 24 lëndë mësimore dhe synon thellimin e njohurive dhe aftësimin profesional të studentëve. [Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Matematikë Informatikë 2021-2022; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Matematikë Informatikë 2022-2023]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë" për vetë natyrën e tij, garanton zhvillimin e aftësive të veçanta të studentëve, kryesisht në fushën e Informatikës si dhe të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.</p> <p>Gjuha e huaj është e përfshirë në vitin e parë të studimeve dhe jep një ndihmesë të konsiderueshme në shfrytëzimin në vijim të literaturës në gjuhë të huaj si dhe lehtëson oportunitetet e mobiliteteve për studentët në institucione arsimore jashtë vendit.</p> <p>Gjithashtu nëpërmjet lëndës me zgjedhje "Shkrim dhe Manaxhim Projektsh" zhvillohen tek studenti aftësitë e manaxhimit, të komunikimit dhe ndërveprimit, të punës në grup, etj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblyëse.</p>	<p>Hartimi, analizimi, shqyrtimi dhe përmirësimi i programeve lëndore organizohen nga grupet mësimore kërkimore nën drejtimin e Përgjegjësit të grupit mësimor kërkimor. [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Neni 19, pika 2/b]</p> <p>Në syllabuset e çdo lënde të programit mësimor Bachelor në "Matematikë Informatikë", studentët informohen në lidhje me kompetencat, aftësitë dhe rezultatet e të nxëniet të fituara në përfundim të saj. [Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Matematikë Informatikë 2022-2023]</p> <p>Gjatë gjithë procesit mësimor, personeli akademik orienton studentët duke vendosur theksin në temat më të rëndësishme të trajtuara në lëndën mësimore. Në përfundim të semestrit akademik, personeli akademik realizon orë të veçanta konsultimi gjatë të cilave studentët orientohen mbi çështjet më të rëndësishme, si dhe çdo pyetje që ata mund të kenë mbi lëndën përkatëse. [Evidenca III.1.11 Orari konsultimeve]</p> <p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, evidentohen me rezultatet e tyre në format e ndryshme të vlerësimit të vazhduar përgjatë vitit si dhe në provimet përfundimtare.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Programet lëndore në programin e studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë", kanë të përfshirë rezultatet e të nxëniet në formën e kompetencave që fiton studenti.</p> <p>Njohuritë e marra teorikisht zhvillohen më tej në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Realizimin e orëve të ushtrimeve/ laboratoreve në auditor</li> <li>- Studimin individual jashtë auditorit</li> <li>- Realizimin e projekteve apo detyrave të kursit, etj.</li> </ul> <p>[Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Matematikë Informatikë 2022-2023]</p> <p>Personeli akademik i DMIF-së mbështet diskutimet dhe punën në grup të studentëve në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara duke krijuar kushtet dhe favorizuar organizimin e punës në grup gjatë orëve të seminareve, seancave laboratorike, detyrave të kursit dhe studimit individual.</p> <p>Gjatë këtij procesi studentët kanë në dispozicion bibliotekën digjitale në UGJ dhe një fond librash, të cilat ndihmojnë studentin për të zhvilluar njohuritë, për t'u aftësuar në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve. Ky fond ndihmon studentin për studime të përparuara kërkimore shkencore.</p> <p>[Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën e Library, Fondi i librit]</p> <p>UGJ dhe personeli akademik i DMIF-së mbështet studentët për të promovuar idetë dhe mendimin e tyre si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të programit të studimit apo në programe mobiliteti, në konferenca, projekte apo seminare studentore. [Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022; Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2023; Evidenca I.25 Lista e</p>

	<b>mobiliteteve të UGJ]</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p> <p><b>[Evidenca III.15 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2019-2020; Evidenca III.15.1 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të 2021-2022; Evidenca III.15.2 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2022-2023; Evidenca III.15.3 Plani i veprimtarisë së DMIF 2019-2020; Evidenca III.15.4 Listë me personat që kanë dhënë mësim ose kanë bërë punë kërkimore në një universitet perëndimor; Evidenca III.15.5 Liste e profesorit të huaj të angazhuar në dhënien e titujve në UGJ]</b></p> <p>Gjatë periudhës 2019-2023 Universiteti "F. Çabej" Gjirokastër dhe DMIF, ka qenë partner në projektin ndërkombëtar TECOMP (Strengthening Teaching Competences in Higher Education in Natural and Mathematical Sciences) të programit Erasmus+.</p> <p>Në kuadër të këtij projekti anëtarë të departamentit morën pjesë në trajnime të vazhdueshme për aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies duke përdorur teknologjitë e informacionit dhe komunikimit. Këto trajnime janë kryer si në distancë (online) ashtu dhe me pjesëmarrje fizike në universitetet partnere të cilat pasqyrohen edhe në faqen zyrtare të projektit.</p> <p><b>[Projekt-TeComp, <a href="http://www.tecomp.ni.ac.rs/training-events">http://www.tecomp.ni.ac.rs/training-events</a>]</b></p> <p>Në UGJ është ngritur dhe funksionon Qendra e të mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (LLL centre) e krijuar si produkt i projektetit për ngritjen e kapaciteteve TEAVET <b>[Evidenca II.33 Memorandum IAL dhe MAS për TEAVET]</b>. Anëtarë të stafit akademik të DMIF-së janë trajnerë të moduleve të trajnimit ofruar për mësues të arsimit parauniversitar <b>[Evidenca II.35 TEAVET-modulet]</b>.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	<p>Zhvillimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar ose punimi i diplomës për studentët e programit e ciklit të parë Bachelor në "Matematikë Informatikë", mbështetet në Kreun VIII "Diplomimi", të Rregullores së Studimeve në UGJ, Nenet 59, 60, 61, 62, 63, dhe 64 <b>[Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër]</b>, Neni 93 të Rregullores së UGJ-së <b>[Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër]</b>, Kreun VII "Diplomimi", Nenet 38, 39 të Rregullores së FSHN-së <b>[Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës]</b> dhe në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë" <b>[Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Matematikë Informatikë, Neni 11]</b>.</p> <p>Në Rregulloren e studimeve në UGJ, Rregulloren e FSHN-së dhe Rregulloren e programit të studimit në Bachelor në "Matematikë Informatikë" përcaktohet qartë pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për të bërë punim diplome. <b>[Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 59, pika 3; Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Neni 38, pika 2; Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Matematikë Informatikë, Neni 11 pika b]</b>.</p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” është program i ciklit të parë të studimeve dhe mbyllet me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome.</p> <p>Në fillim të vitit të fundit të studimeve DMIF asiston studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose mbrojtjes së diplomës, në respektim të Rregullores së studimeve në UGJ [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 61] dhe shtojcave të kësaj Rregulloreje [Evidenca III.11.2. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve]. Rregullore së Programit të studimit të Bachelor në “Matematikë Informatikë” [Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Matematikë Informatikë, Neni 11 pika c] dhe Programit të provimit të përgjithshëm përfundimtar. [Evidenca III.11 Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar Bachelor në Matematikë Informatikë]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Provimi i përgjithshëm përfundimtar/mbrojtja e punimit të diplomës realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga personel akademik të departamentit, të fushave që mbulon programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar. Anëtarët e komisionit propozohen nga Departamenti dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 62, pika 3, Neni 64]</p> <p>Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga personeli akademik i DMIF-së, miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit, si dhe Dekani i Fakultetit. [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 62, pika 2; Evidenca III.11. Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar Bachelor në Matematikë Informatikë]</p> <p>Tezat e provimit të përgjithshëm përfundimtar hartohen në përputhje me programin e provimit të përgjithshëm përfundimtar nga anëtarët e komisionit, firmosen nga Përgjegjësi i Departamentit dhe miratohen nga Dekani [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 62, pika 4; Evidenca III.12.1 Model i unifikuar i tezës së provimeve]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>DMIF, në fillim të vitit të fundit të studimeve përcaktojnë fushat e studimeve për punimin e diplomës [Evidenca III.11.1 Miratimi i fushave të studimit]. Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit duke vendosur afatet e përafërta të realizimit të tij, përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Para mbrojtjes së tezës së diplomës udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studentit dhe lejon mbrojtjen e punimit duke firmosur tezën e diplomës.</p> <p>Punimi i diplomës bëhet duke mbajtur në konsideratë udhëzimet në Manualin e punimit të diplomës, sipas shtojcës bashkëngjitur Rregullore së studimeve në UGJ [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 61; Evidenca III.11.2. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>DMIF ofron mundësitë për të shfrytëzuar infrastrukturën laboratorike të tij për përgatitjen e temës së diplomës nën drejtimin e udhëheqësit. [Evidenca III.2. Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në DMIF; Evidenca III.3. Inventari i mjeteve laboratorike në DMIF]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. Vlerësimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar ose mbrojtjes së punimit të diplomës pasqyrohet në procesverbalin përkatës. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose mbrojtjes së punimit të diplomës. [Evidenca I.4</p>



	<b>Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 62, pika 5 dhe 6, Neni 64 pika 3 dhe 4; Evidenca III.11.2. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve]</b>			
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studentët e programit të studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” në përfundim të studimeve pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 65; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 76; Evidenca II.5 Model diplome Bachelor në Matematikë Informatikë; Evidenca II.6.1 Model suplementi i diplomës] Suplementi i Diplomës për programin e studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” është në përputhje me Udhëzimin Nr. 11, datë 02.04.2020 “Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së Suplementit të Diplomës” të MASR-së [Evidenca II.6.2 Udhëzim Nr.11, dt. 02.04.2020 “Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së Suplementit të Diplomës” të MASR]. Pas diplomimit, me kërkesën e tij, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, me syllabuset përkatëse.			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni ruan përgjatë viteve të studimit kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga institucioni kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. UGJ në përputhje me Nenin 101 të Ligjit të arsimit të lartë, Statutin e UGJ-së [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Neni 44] si dhe Rregulloren e Sekretarisë Mësimore [Evidenca III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore, Neni 4] administron dokumentacionin e mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Regjistrin themeltar të studentëve.</li> <li>• Regjistrin e arritjeve akademike.</li> <li>• Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin	Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, bazuar në Nenin 25, pika 4 dhe Nenin 59, pikat 3, 4, 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” pasi ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin, dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit të studimit

Adresa: Rruga "Studenti"  
Lagja "18 Shtatori", Gjirokastrë 6001  
Tel:+355 84263408

E-mail: rektori@uogj.edu.al

Web site: www.uogj.edu.al



<p>e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>dhe ka së paku kualifikim të ciklit pasardhës.</p> <p>[ANEKS-Tabelat Përmbledhëse Tabelat 6.1, 6.2, 6.3 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit Bachelor në Matematikë Informatikë]</p> <p>Niveli i kualifikimit të personelit akademik që mbulon programin e studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë" është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e lëndëve të tij.</p> <p>[ANEKS-Tabelat Përmbledhëse Tabela 6.1, 6.2, 6.3 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit Bachelor në Matematikë Informatikë; Evidenca III.4 CV-të e personelit akademik dhe ndihmës akademik; ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Tabelat 12.1, 12.2, 12.3 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës].</p> <p>Kualifikimet dhe publikimet e personelit akademik pasqyrohen në Raportet Vjetore të Grupeve mësimore kërkimore si pjesë e Raporteve Vjetore të veprimtarisë mësimore shkencore të DMIF-së, dhe në Raportet Vjetore të veprimtarisë mësimore kërkimore të FSHN-së.</p> <p>[Evidenca I.13 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në DMIF 2019 -2020; Evidenca I.13.1 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në DMIF 2020-2021; Evidenca I.13.2 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në DMIF 2021-2022; Evidenca II.29 Raport vjetor i aktivitetit të grupit mësimor kërkimor AMZF; Evidenca II.29.1 Raport vjetor i aktivitetit të grupit mësimor kërkimor AGJI; Evidenca I.12 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FSHN 2019-2020; Evidenca I.12.2 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FSHN 2020-2021; Evidenca I.12.4 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FSHN 2021-2022]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore të programit të studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi bazuar në Nenin 59, pikat 3, 4, 5, 6 të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe V.K.M Nr.418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre".</p> <p>Personeli akademik efektiv ka së paku kualifikimin e ciklit pasardhës dhe mbulon jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për programin e studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë".</p> <p>[Evidenca IV.1 V.K.M Nr.418, datë 10.05.2017, pika 2, gërma a, nënpika xii, pika 2, gërma b, nënpika i, nënpika ii; Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Tabelat 12.1, 12.2, 12.3 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës; Evidenca II.13.2 Raporti i kapaciteteve pritëse viti akademik 2023-2024].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>UGJ garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë", për të gjithë periudhën e akreditimit.</p> <p>[Evidenca IV.3 Listëpagesa, Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të personelit akademik Janar-Maj 2023; Evidenca IV.3.1 Model kontratë individuale e punës me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar; Evidenca IV.3.2 Model kontratë individuale e punës me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pacaktuar]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin</p>	<p>UGJ harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore.</p> <p>[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, Neni 56; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Nenet 27, 29; Evidenca I.27 Rregullore e punësimit të personelit akademik dhe administrativ, Nenet 3, 5, 8 dhe 9]</p>

<p>e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>DMIF, bazuar në nevojat e tij, përcakton kriteret e përgjithshme [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 27] dhe specifike të punësimit të personelit akademik në përputhje me natyrën, strukturën, lëndët mësimore dhe përmbajtjen e programit të studimit.[Evidenca IV.4 Propozim për personel akademik me kohë të plotë; Evidenca IV.4.1 Propozim për personel akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar]</p> <p>Kërkesa për punësim i përcillet Rektorit të Universitetit, përmes Dekanit të Fakultetit. Pas miratimit të kërkesës dhe kriterëve nga Rektori si dhe shpalljes së tyre në Buletinin e Njoftimeve Publike [Evidenca IV.4.2 Buletini njoftimeve publike], Rektori me urdhër ngre një komision "ad-hoc" për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave për vendin vakant, me 5(pesë) anëtarë, i përbërë nga Dekani i Fakultetit i cili kryeson komisionin [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 33, gërma "h"], 3 (tre) anëtarë pjesë e personelit akademik të Njesisë bazë përkatëse dhe 1(një) anëtar nga Rektorati. Struktura e manaxhimit të burimeve njerëzore mbështet komisionin "ad-hoc" në zhvillimin e procedurave konkurruese [Evidenca IV.6 Procedurë e punësimit të personelit akademik në DMIF]</p> <p>Në rastin e konkursit të punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar komisioni "ad-hoc" ngrihet nga Dekani i Fakultetit. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 33, gërma "f"]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>UGJ siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore.</p> <p>[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 45; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 37; Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Neni 15]</p> <p>Pjesë përbërëse e DMIF-së në ndihmë të realizimit të orëve laboratorike dhe mirëmbajtjes së laboratorëve dhe mjediseve të tjera mësimore është edhe 1(një) personel ndihmës akademik me karakter mësimor, i cili zotëron aftësitë e nevojshme profesionale për vëndin përkatës të punës.</p> <p>[Evidenca I.7 Rregullore e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, Neni 12; Evidenca I.15 Organograma e Fakultetit të Shkencave të Natyrës; Evidenca I.16 Organograma e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës; Evidenca IV.7 Detyrat dhe ngarkesa e personelit ndihmës akademik; Evidenca III.4 CV-të e personelit akademik dhe ndihmës akademik]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Bazuar në Statutin e UGJ-së [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Nenet 41, 42], funksionon Sektori i Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sekretari-Protokoll, si pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës akademike Administrative (DSHNA), e cila është struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave personale të personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ, parashikuar në Rregulloren e saj dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi [Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Nenet 4, 5; Evidenca IV.3.1 Model kontratë individuale e punës me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar; Evidenca IV.3.2 Model kontratë individuale e punës me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pacaktuar; Evidenca IV.3.3 Model dosje personeli].</p> <p>Të dhënat personale përfshijnë CV-të e personelit, kartën e identitetit, pozicionin e punës, diplomat dhe listat e notave, gradat shkencore dhe titujt akademik, dëshmi të gjuhëve të huaja, dëshmi të trajnimeve dhe kualifikimeve të ndryshme, dëshmi penaliteti, raport mjeko-ligjor etj.</p> <p>Përsa i përket promovimit akademik dhe aktivitetit kërkimor shkencor të personelit akademik në UGJ funksionon Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, i cili mbledh, ruan dhe përditëson të dhëna mbi kërkimin shkencor të</p>

	<p>personelit akademik, pjesëmarrjes në projekte kombëtare/ndërkombëtare, zhvillimit të kapaciteteve didaktike dhe kërkimore shkencore nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit si dhe pjesëmarrjes në trajnime e workshope.</p> <p><b>[Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Neni 17]</b></p> <p>I ë dhënat përfshijnë gjithashtu edhe angazhimin e personelit akademik në çdo vit akademik dhe semester si dhe planifikimin e kohës vjetore të punës të personelit akademik dhe ndihmës akademik, të dhëna që arkivohen pranë DMIF-së.</p> <p><b>[Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Neni 45, gërma b; Evidenca I.7 Rregullore e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, Neni 42; Evidenca IV.8 Model i ngarkesës mësimore të personelit akademik; Evidenca IV.8.1 Model planifikimi i kohës vjetore të punës të personelit akademik]</b></p> <p>Në Statutin e UGJ-së, Rregulloren e UGJ-së, Rregulloren e FSHN-së si dhe Rregulloren e DMIF-së përcaktohen edhe detyrat e personelit ndihmës akademik me karakter mësimor.</p> <p><b>[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 45, pika 3; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 41; Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Neni 15; Evidenca I.7 Rregullore e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, Neni 12; Evidenca IV.7 Detyrat dhe ngarkesa e personelit ndihmës akademik]</b></p> <p>Mbledhja, ruajtja dhe përditësimi për çdo vit akademik i këtyre të dhënave, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.</p> <p><b>[Evidenca IV.2 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale; Evidenca IV.2.3 Udhëzues mbi Privatësinë]</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>UGJ por edhe FSHN kanë disa marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale, temat e diplomave si dhe orë të tjera praktike. Mund të përmëndim marrëveshjet me Drejtorinë Rajonale të Arsimit, Drejtorinë e Spitalit Rajonal, që përbëhen nga personel me kualifikim profesional të lartë, por edhe subjekte private që kanë shkallë të lartë ekspertize profesionale dhe që garantojnë ndjekjen e studentëve gjatë zhvillimit të praktikave nga ana e tyre.</p> <p><b>[Evidenca I.23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ; Evidenca IV.9 Marrëveshje me Drejtorinë Rajonale të Arsimit; Evidenca IV.9.1 Marrëveshje me Drejtorinë e Spitalit Rajonal]</b></p> <p>Programi Bachelor në "Matematikë Informatikë" nuk e ka përfshirë praktikën e detyruar profesionale në studimet 3 vjeçare. <b>[Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Matematikë Informatikë 2021-2022]</b></p> <p>Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës i në fillim të vitit të fundit të studimeve përcaktojnë fushat e studimeve për punimin e diplomës. <b>[Evidenca III.11.1. Miratimi i fushave të studimit]</b> Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur afatet e përafërta të realizimit të tij, përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. <b>[Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 61, Evidenca III.11.2. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve]</b></p> <p>DMIF ofron mundësitë për të shfrytëzuar infrastrukturën laboratorike të FSHN-së për përgatitjen e temës së diplomës nën drejtimin e udhëheqësit.</p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të</p>	<p>Programi Bachelor në "Matematikë Informatikë" nuk e ka përfshirë praktikën e detyruar profesionale në studimet 3 vjeçare.</p> <p><b>[Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Matematikë Informatikë 2021-2022]</b></p>

ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UGJ ushtron aktivitetin e tij në 3 (tre) godina universitare. Godina A me sipërfaqe 3255.5 m<sup>2</sup>, Godina B me sipërfaqe 1937 m<sup>2</sup> dhe godina C me sipërfaqe 729.6 m<sup>2</sup>, Këto godina janë të ndërtuara me materiale cilësore bashkëkohore të cilat plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për studentët dhe personelin akademik e administrativ. <b>[Evidenca IV.10.1 Leje higjieno-sanitare].</b> Godinat plotësojnë standartet teknike dhe ofrojnë akustikë të mirë dhe janë të izoluar nga zhurmat, luhatjet e temperaturës dhe lagështirës. Godinat shtrihen në qendër të zonës urbane larg zonave të zhvillimit industrial apo me ndotje, të cilat gjenden në periferi të qytetit. UGJ i plotëson normativat teknike të ndriçimit natyral, sipërfaqja e dritareve mbulon minimalisht (15 – 20) % të sipërfaqes së dyshemesë dhe ndriçimi është i orientuar nga krahu i majtë i studentit, dhe lartësia e ambienteve është jo më e vogël se 3.0 m (tavan-dysheme). UGJ ka një sistem të mbrojtjes së shkarkesave atmosferike si dhe një sistem të mbrojtjes kundra zjarrit. Çdo godinë është e pajisur me sinjalizues dhe në hollet e çdo godine janë të instaluar bombola kundra zjarrit si dhe hidratantë, të cilët janë të shoqëruar edhe me sinjalistikën përkatëse <b>[Evidenca IV.10.2 Çertifikatë për sigurinë nga zjarri].</b></p> <p>Institucioni siguron në pjesën më të madhe të sallave dhe zyrave sisteme ajri të kondicionuar, ndërkohë që Godinat A, B dhe C kanë të instaluar sistemin e ngrohjes së centralizuar (kaldaja). UGJ disponon burime alternative për furnizimin me energji elektrike (një motogenerator në Godinën A) dhe rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm, pasi uji është i pandërprerë 24 orë.</p> <p>Bazuar në Raportin e MAS-së mbi “Verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara për vitin akademik 2023-2024”, UGJ ofron një normativë të pritshme mesatare prej 2.5 m<sup>2</sup>/student, llogaritur kjo në dy fasha orare kjo normativë shkon në 5 m<sup>2</sup>/student <b>[Evidenca II.13.2 Raporti i kapaciteteve pritëse viti akademik 2023-2024]</b></p> <p>UGJ siguron mjediset të përshtatshme në funksion të veprimtarisë mësimore dhe në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” dhe lëndëve të tij, si dhe në përputhje me standartet dhe normativat për infrastrukturën, të përcaktuara në V.K.M Nr. 418, datë 10.05.2017. “Për standartet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre. <b>[Evidenca IV.1 V.K.M Nr. 418, datë 10.05.2017; Evidenca II.13.2 Raporti i kapaciteteve pritëse viti akademik 2023-2024; ANEKS-Tabelat Përmbledhëse Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Tabela 16)]</b></p> <p>Veprimtaritë mësimore si leksionet dhe seminarët e programit të studimit, zhvillohen në Godinën A, përfshi dhe laboratorët e Fizikës kurse laboratorët e</p>

	Informatikës ndodhen në Godinë B.			
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies	Për realizimin e programit të studimit Bachelor në "Matematike Informatikë" UGJ ka vendosur në dispozicion të Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës mjedise mësimore si klasa, laboratorë, si dhe mjedise të tjera për personelin akademik dhe ndihmës akademik, të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që kanë akses të plotë në rrjetin Lan dhe WiFi Internet, në ndihmë të përgatitjes dhe të realizimit të procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. [Evidenca III.2. Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në DMIF; Evidenca IV.11 Inventari i DMIF]			
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Për plotësimin e kërkesave të lëndëve mësimore, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formuese të programit të studimit Bachelor në "Matematike Informatikë", DMIF disponon 4 (katër) laboratorë të Informatikës (Godina A, Salla 201, Godina B Sallat 401, 402, 403) të pajisur me PC, mjete kompjuterike dhe WiFi Internet, videoprojektorë, dhe 4 (katër) Laboratorë të Fizikës (Godinë A, Sallat 310, 311, 312, 313) të pajisur me aparaturat dhe mjetet e përshtatshme laboratorike [Evidenca III.2. Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në DMIF; Evidenca III.3. Inventari i mjeteve laboratorike në DMIF]			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Për realizimin e programit të studimit Bachelor në "Matematike Informatike", UGJ siguron 4 (katër) laboratorë të Informatikës (teknologjisë së informacionit), të cilët janë të pajisur me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që kanë akses të plotë në rrjetin Lan dhe WiFi Internet, të cilët garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodave teknologjike bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies.[Evidenca IV.10 Infrastruktura e UGJ; Evidenca III.2. Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në DMIF]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.3

**IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Në zbatim të Rregullores së studimeve në UGJ, literatura bazë e detyrueshme përbëhet nga tekstet mësimore dhe ciklet e leksioneve. [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 27; Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Neni 21; Evidenca I.7 Rregullore e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, Neni 18; Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Matematikë Informatikë, Neni 7] Literatura bazë dhe ndihmëse e lëndëve që i përkasin fushës së Matematikës ofrohet përgjithësisht në gjuhën shqipe dhe mbështetet kryesisht në tekste mësimore të botuara nga autoritete të mirënjohur shkencorë të Universiteteve publike, kryesisht Universitetit të Tiranës, kurse për lëndët që i përkasin fushës së Informatikës literatura ofrohet përgjithësisht në gjuhën angleze dhe u përkasin autorëve të mirënjohur të huaj të kësaj fushe. Literatura bazë dhe ndihmëse u vihet në dispozicion studentëve në formë fizike

	<p>dhe/ose digjitale, dhe garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në këtë program studimi.</p> <p>Gjithashtu dhe fondi i literaturës fizike dhe online në Bibliotekën e Universitetit mbështet marrjen e dijeve të nevojshme në këtë program studimi.</p> <p>I literatura bazë dhe ndihmëse propozohet nga anëtarët e personelit akademik, shqyrtohet në Grupet mësimore kërkimore, aprovohet nga DMIF dhe pasqyrohet në programet lëndore të programit të studimit.</p> <p><b>[Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Neni 10, pika b, Neni 21; Evidenca I.7 Rregullore e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, Neni 18; Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Matematikë Informatikë, Neni 7; Evidenca IV.12 Miratimi i literaturës bazë në DMIF 2020-2021; Evidenca IV.12.1 Miratimi i literaturës bazë në FSHN 2020-2021; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Matematikë Informatikë 2022-2023]</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>DMIF, përpara miratimit të buxhetit vjetor institucional, paraqet propozimin e tij për përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit. <b>[Evidenca IV.13 Kërkesë për blerje librash]</b> Propozimet e DMIF miratohen sipas procedurave përkatëse të Institucionit. <b>[Evidenca IV.13.1 Raportime nga biblioteka për departamentin]</b></p> <p>Edhe Biblioteka paraqet kërkesat e saj për pasurimin e fondit të saj në çdo fillim viti akademik, duke kërkuar të ketë një zë përkatës në buxhetin institucional. Përveç pasurimit periodik që realizohet me fondet e UGJ-së, literatura e Bibliotekës pasurohet edhe përmes donacioneve të miqve të UGJ-së.</p> <p><b>[Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>UGJ vë në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik, në mbështetje të procesit mësimor dhe formimit të tyre profesional, Bibliotekën Akadematike e cila ndodhet në Godinën C të Universitetit.</p> <p>Biblioteka disponon 3 (tre) salla leximi, të cilat janë të pajisura me kompjutera dhe me mjete audio vizive. Biblioteka disponon fond librash në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, në të cilat gjëndet një numër tekstesh të fushës së programit të studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë". Biblioteka shërben edhe si sallë interneti <b>[Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]</b></p> <p>Të gjithë studentët kanë mundësi të barabartë në përdorimin e saj. Literatura mësimore mund të shfrytëzohet në ambjentët e Bibliotekës ose dhe jashtë saj. Studenti disponon një kartelë personale të përdoruesit, përmes së cilës siguron literaturën. Kartela personale e përdoruesit përmban informacione të tilla si numrin e kartelës, emrin, mbiemrin, atësinë, adresën e banimit, numrin personal të identifikimit, numrin e telefonit, fakultetin, degën etj., si dhe nënshkrimet e përgjegjësit të bibliotekës dhe lexuesit. <b>[Evidenca IV.14 Biblioteka, Kartelë personale e përdoruesit]</b></p> <p>UGJ ka vënë në dispozicion të studentëve edhe përdorimin e librarive elektronike ku ata mund të shfrytëzojnë edhe literaturë në gjuhë të huaj.</p> <p><b>[Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Literatura e ofruar, përmes Bibliotekës është multidisiplinare. Në Bibliotekë gjenden tituj nga fusha të ndryshme studimi, Të interesuarit gjejnë në Bibliotekë literaturë për çështje të përgjithshme, për shkencën dhe diturinë, për filozofinë, psikologjinë, shkencat shoqërore dhe nëndarjet e tyre ekonomike dhe nëndarjet e saj, drejtësinë, matematikën dhe shkencat e natyrës, shkencat e aplikuar si mjekësia dhe teknologjia, linguistika dhe letërsia, historia, gjeografia, si dhe materiale që trajtojnë artin, kulturën dhe sportin.</p> <p>Abonimi prej shumë vitesh, i Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, i mbështetur nga UGJ, në rrjetin zyrtar ndërkombëtar "Mathematical Scientific Net" [<a href="https://mathscinet.ams.org/mathscinet">https://mathscinet.ams.org/mathscinet</a>] e cila është nën kujdesin e Shoqatës Amerikane të Matematikës (AMS), ofron akses në një bazë të dhënash të</p>

	mirëmbajtur me kujdes dhe lehtësisht të kërkueshme të literaturës së shkencave Matematikore. [Evidenca II.31 Abonim në rrjetin MathsciNet]			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	UGJ në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, mbështur prej MAS, ka mundësuar për stafin akademik dhe studentët shërbimin "on-line" të Bibliotekës "ULibrary". [https://ulibrary.rash.al/] Në faqen zyrtare ueb të UGJ - së, [https://uogj.edu.al/biblioteka online/], personeli akademik dhe studentët kanë mundësi të aksesojnë "on-line", literaturë të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit duke ndjekur udhëzimet e manualit përkatës Ky shërbim ofrohet pa pagesë për studentët dhe personelin akademik. [Evidenca IV.14.1 Biblioteka, Manuali i përdorimit] Çjithashtu, nëpërmjet abonimit të Bibliotekës në revista shkencore udhëkombëtare online, studentëve/pedagogeve ju ofrohet mundësia e aksesimit të literaturës në gjuhë të huaj. [Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit; Evidenca II.31 Abonim në rrjetin MathsciNet]			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka është e pajisur me kompjutera, programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. [Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]			
<b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka ofron shërbimin prej punonjësve të saj për studentët dhe personelin akademik ditët e javës, e Hënë - e Premte (me përjashtim të ditëve zyrtare të pushimit), në orarin 08.00-19.00, në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor por dhe përtej tyre, në përgjigje të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. Orari është i afishuar në mjediset e institucionit dhe në hyrje të Bibliotekës. Për çdo student ka kartelë personale të përdoruesit. [Evidenca IV.14.2 Rregullore e Bibliotekës; Evidenca IV.14 Biblioteka, Kartelë personale e përdoruesit]			
<b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Biblioteka ndjek dhe raporton mbi cilësinë e fondit fizik të saj dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah efektshmërinë e përpjekjeve për pasurim të fondit fizik, dhe atij online [Evidenca IV.13.1 Raportime nga biblioteka për departamentin; Evidenca III.9 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



*[Handwritten signatures and initials in blue ink]*



**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>UGJ është pjesë e rrjetit akademik shqiptar RASH dhe QSIIA. Nëpërmjet platformave të ofruara prej tyre realizohet procesi i aplikimit dhe regjistrimit on-line të kandidatëve (maturantëve U-Albania) në programet e UGJ-së, si dhe matrikullimi i studentëve, bazuar në të dhënat e detajuara të përcjella nga UGJ.</p> <p>UGJ në përputhje me Nenin 101 të Ligjit të arsimit të lartë. Statutin e UGJ-së [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, Neni 44] si dhe Rregulloren e Sekretarisë Mësimore [Evidenca III.13 Rregullore e sekretarisë mësimore, Neni 4] administron:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Regjistrin themeltar të studentëve.</li> <li>• Regjistrin e arritjeve akademike</li> <li>• Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.</li> </ul> <p>UGJ disponon gjithashtu sistemin elektronik Pitagora, aplikacion softuerik i sekretarisë online i zhvilluar nga RASH (Rrjeti Akademik Shqiptar), që ofron funksionalitete për administratën, sekretarinë dhe përdoruesit fundor (student, pedagog, etj.)</p> <p>[<a href="https://uogj.pitagora.rash.al/login">https://uogj.pitagora.rash.al/login</a>]</p> <p>Disa nga funksionalitetet kryesore të kësaj platforme janë:</p> <p><b>Hapësira didaktike:</b> Struktura Akademike, Menaxhimi i Karrierës së Studentit, Provime dhe Tema e Diplomës.</p> <p><b>Hapësira administrative:</b> Pranimi dhe Regjistrimi, Orari dhe provimet, Menaxhimi i Studentëve.</p> <p><b>Tarifat:</b> Menaxhimi i Tarifave të studimit, Bursa për studentët, Periudha Financiare.</p> <p><b>Diplomimi:</b> Provimet e Shtetit, Praktika studentore, Diploma Online dhe Suplementi.</p> <p>Në UGJ ka funksionuar për disa vite edhe sistemi elektronik i automatizimit të proceseve të sekretarisë mësimore dhe shërbimeve online për studentët ESSE3 me funksionalitetet e përcaktuara në Rregulloren e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3.</p> <p>[Evidenca IV.15 Rregullore e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Në UGJ administrimi i dokumentacionit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ realizohet nga Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike – Administrative. Dokumentacioni që ruhet dhe administrohet përfshin</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Regjistrin themeltar</li> <li>• Dosjet personale të punonjësve dhe kontratat e punës</li> <li>• Librezat e punës së punonjësve</li> </ul> <p>dhe çdo dokumentacion tjetër për ruajtje të dhënë nga Rektori, apo Administratori i Universitetit. [Evidenca IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Nenet 3, 4, 5]</p> <p>Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënive me Jashtë administron dhe përditëson bazën e të dhënave të kërkimit shkencor të personelit akademik dhe kërkimor. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, Neni 82]</p> <p>Bazuar në Rregulloren e FSHN-së [Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Neni 45], FSHN dhe DMIF ruajnë kujdes dokumentacionin përkatës në lidhje me personelin akademik si ngarkesën vjetore mësimore, marrëveshjet e realizimit të kohës vjetore të punës, programet lëndore etj.</p> <p>[Evidenca IV.8 Model i ngarkesës mësimore të personelit akademik; Evidenca IV.8.1 Model planifikimi i kohës vjetore të punës të personelit akademik; Evidenca II.28 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Bachelor në Matematikë Informatikë 2022-2023]</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit</p>	<p>UGJ nëpërmjet sistemit elektronik Pitagora [<a href="https://uogj.pitagora.rash.al/login">https://uogj.pitagora.rash.al/login</a>], u siguron akses të dedikuar dhe konfidencial në informacione dhe dokumente, të gjithë personelit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve të Programit të Studimit Bachelor në "Matematikë Informatikë".</p> <p>Personeli akademik dhe ndihmës akademik (sekretaria mësimore) ka akses në llogaritë e tyre, ku shfaqen të dhëna mbi lëndët mësimore, sezonet e provimeve, oraret e tyre, lista e studentëve të regjistruar, procesverbale provimi etj. Ndërsa studentët mund të aksesojnë informacione dhe të dhëna rreth statusit të tyre, lëndëve që frekuentojnë, vlerësimet në çdo lëndë etj. Gjithashtu informacionet dhe dokumentacionet në lidhje me programin e studimit si Rregullore e programit të studimit, Misioni i programit të studimit, Plani mësimor, Struktura mësimore, Oraret mësimore etj., janë të publikuara edhe në faqen zyrtare ueb të UGJ -së. [<a href="https://uogj.edu.al/">https://uogj.edu.al/</a>]</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Format e komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve përfshijnë përveç faqes ueb dhe postës elektronike zyrtare edhe platformat elektronike si: Microsoft Office 365, Microsoft Teams etj [<a href="https://uogj.edu.al/platforma-office-365-dhe-teams-per-mesimin-online/">https://uogj.edu.al/platforma-office-365-dhe-teams-per-mesimin-online/</a>]; <b>Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik;</b> <b>Evidenca III.1.5 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentet</b> Gjithashtu, në kuadër të projektit Erasmus+, TeComp, në UGJ është pilotuar edhe platforma elektronike "LearningKey" me funksionalitete si: Krijimi i kurrikulës, Krijimi i detyrave të shtëpisë, Platforma e testimit, Klasë virtuale, Programuesi i klasës, Kalandari personal, Menaxhimi i grupeve, Krijimi i brandit personal etj. [<b>Evidenca IV.18 Urdhër për përdorimin e platformës Learning Key;</b> <a href="http://www.tecomp.ni.ac.rs/">http://www.tecomp.ni.ac.rs/</a>; <a href="http://www.tecomp.ni.ac.rs/download/LearningKey-Guideline_eng-1.pdf">http://www.tecomp.ni.ac.rs/download/LearningKey-Guideline_eng-1.pdf</a>]</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Platformat elektronike (ESSE3, Pitagora, Microsoft Office 365, Microsoft Teams, LearningKey) garantojnë monitorim të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Sipas nevojave, këto sisteme mundësojnë raportime individuale mbi ecurinë akademike të studentëve, pagesën e tarifës së studimit, monitorimin dhe afatet e hedhjes së vlerësimeve nga ana e personelit akademik etj.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Në faqen zyrtare ueb të UGJ-së, bazuar në Statutin e UGJ [<b>Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 60</b>], DMIF publikon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Informacione që lidhen me programin e studimit si: Rregullorja e programit të studimit, Misioni i programit të studimit, Plani mësimor i tij, Struktura mësimore, Orari mësimor, kalandari i provimeve etj,</li> <li>• Informacione mbi DMIF-në dhe personelin akademik të tij.</li> <li>• Informacione mbi aktivitete të ndryshme etj</li> </ul> <p>të cilat janë në gjuhën shqipe dhe angleze. [<a href="http://uogj.edu.al/">http://uogj.edu.al/</a>]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>



<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>UGJ harton një raport financiar të kostove dhe mbështetjes financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Hartimi i këtij raporti financiar bazohet në Statutin e UGJ dhe bëhet sipas modelit të buxhetit të shtetit, i përcaktuar në udhëzimin përkatës të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, Neni 103]</p> <p>Projekt buxheti vjetor hartohet nga Administratori i UGJ-së, mbi bazën e propozimeve të Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë, mbështetur në Planin Strategjik të zhvillimit të UGJ-së, Planin buxhetor afatmesëm, dhe miratohet nga Bordi i Administrimit me propozim të Senatit Akademik</p> <p>[Evidenca IV.16 Propozim buxheti DMIF; Evidenca I.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër 2020-2025, Kreu Financat dhe Burimet Financiare, fq. 34; Evidenca IV.16.4 Projekt Buxheti për vitin 2023 dhe programi i buxhetit afatmesëm 2023-2025]</p> <p>Pas miratimit buxheti i detajuar kalon për menaxhim në Drejtorinë e Shërbimeve Universitare dhe delegohet në varësi të kërkesave apo nevojave të njësive.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani i financimit institucional përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për Bibliotekën, për pasurimin e literaturës së saj si dhe aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p> <p>[Evidenca IV.16.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca IV.16.2 Evidenca IV.16.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca IV.16.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022; ANEKS-Tabelat Përmbledhëse-Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit (Tabela 18)]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij në mënyre periodike. Drejtoria e Shërbimeve Universitare harton dhe paraqet Raportin Financiar Vjetor, sipas kërkesave ligjore në fuqi ku paraqiten të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet.</p> <p>[Evidenca IV.16.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca IV.16.2 Evidenca IV.16.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca IV.16.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022]</p> <p>Gjithashtu në mënyre periodike UGJ, si çdo institucion publik, i nënshtrohet auditit financiar prej Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe MAS.</p> <p>[Evidenca IV.17 Raporti përfundimtar i KLSH-së për performancën e Universiteteve; Evidenca IV.17.1 Raport i MASR AUDIT 2018; Evidenca IV.17.2 Raport i MAS AUDIT 2022]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Drejtoria e Shërbimeve Universitare dhe Administratori i UGJ-së raportojnë për realizimin e buxhetit të miratuar në vitin paraardhës në Senatin akademik të UGJ-së dhe Bordin e Administrimit.</p> <p>[Evidenca IV.16.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca IV.16.2 Evidenca IV.16.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca IV.16.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022]</p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Burimet e financimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, si institucion publik janë dy :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Financim nga buxheti i shtetit.</li> <li>• Financim nga të ardhurat dytësore të cilat sigurohen nëpërmjet studentëve si: tarifat e regjistrimit, tarifat e shkollimit, dhe të ardhurat nga shërbimo të tjera që ofron institucioni.</li> </ul> <p>Më qëllim mirëmenaxhimin e këtyre fondeve dhe sigurimin e një qëndrueshmërie financiare, gjatë analizës financiare vjetore shqyrtohet edhe realizimi i treguesve mbi zbatimin e politikës financiare të vet institucionit.</p> <p>[Evidenca IV.16.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca IV.16.2 Evidenca IV.16.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca IV.16.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022; ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit (Tabela 18)]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës IV</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p><b>Standardi V.1</b> Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UGJ harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> <p>Pranimet e studentëve në UGJ në të gjitha programet e studimeve bëhen me vendim të Senatit Akademik, në përputhje me standartet shtetërore, të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore, kuotave dhe kriterëve të propozuara nga Njësia bazë si dhe legjislacionin në fuqi.</p> <p>[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Neni 62; Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 49; Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Neni 16; Evidenca I.7 Rregullore e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, Neni 13; Evidenca V.1 Udhëzim Nr.12 datë 30.6.2023 Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në IAL; Evidenca V.1.1 Urdhër i përbashkët RASH dhe QSHA Nr 10 datë 10-07-2023, për miratimin e kalendarit 2023-2024; Evidenca V.2 Kuotat e pranimit viti akademik 2023-2024; Evidenca V.2.1 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024; Evidenca II.13.1 Kriteret e pranimit të studentëve 2022-2023; Evidenca II.13 Vendim Senatit Akademik për kriteret 2022-2023; Evidenca II.13.3 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2022-2023; Evidenca II.11 Vendim Senatit Akademik për kuotat 2021-2022; Evidenca II.11.1 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2021-2022; Evidenca II.12.1 Kriteret e pranimit të studentëve 2021-2022]</p>



	<p>Kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” është 3(tre) vite akademike. Programi i studimit është i organizuar në lëndë mësimore dhe i vlerësuar me 180 kredite sipas Sistemit European të Grumbullimit dhe Transferimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Studentët në programin e studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome.</p> <p>Me përfundimin e këtij programi studimi, lëshohet Diplomë Universitare Bachelor në “Matematikë Informatikë”.</p> <p>[Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Matematikë Informatikë 2021-2022; Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Matematikë Informatikë; Evidenca II.5 Model diplome Bachelor në Matematikë Informatikë]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Statuti i UGJ-së [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Neni 65, pika 6 dhe KREU X], përshkruan qartë kriteret e pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve si dhe të drejtat dhe detyrimet e studentëve gjatë studimeve universitare, të cilat udhëhiqen nga parimi i barazisë.</p> <p>Rregullorja e UGJ-së, Rregullorja e FSHN-së dhe Rregullorja e DMIF-së [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë; Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës; Evidenca I.7 Rregullore e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë] përmbajnë në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikatat e trajtimit të studentëve që nga regjistrimi i tyre, e deri në përfundim të studimeve, apo procedurat dhe praktikatat e transferimit të tyre, gjë që garanton qartësisht politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit Bachelor në “Matematikë Informatikë”. [Evidenca V.3 Dosja personale e studentit nga hyrja deri në diplomim; Evidenca II.20 Procedurë e transferimit të studentëve]</p> <p>Ne faqen zyrtare ueb të UGJ-së publikohen informacione mbi kriteret dhe kuotat e pranimeve për çdo vit akademik, si dhe Rregulloret institucionale për ecurinë akademike të studentëve.</p> <p>[<a href="https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/">https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/</a>;  <a href="https://uogj.edu.al/statuti-i-universitetit/">https://uogj.edu.al/statuti-i-universitetit/</a>;  <a href="https://uogj.edu.al/rregullore-e-universitetit/">https://uogj.edu.al/rregullore-e-universitetit/</a>]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>UGJ harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve propozohen nga Njësitë Bazë në përgjigje të kërkesës së MAS dy vite përpara, ndërsa kuotat e pranimeve një vit përpara fillimit të vitit akademik.</p> <p>[Evidenca V.2.1 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024; Evidenca V.2.2 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2024-2025; Evidenca V.2 Kuotat e pranimit viti akademik 2023 - 2024; <a href="https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/">https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/</a>]</p> <p>Propozimet nga Njësitë bazë, përcillen në Rektorat dhe miratohen nga Senati akademik. [Evidenca V.2.3 Vendim Senati Akademik për miratimin e kriterëve 2024-2025 dhe kuotave 2023-2024].</p> <p>Këto kriteret janë në përputhje me VKM-të në fuqi. [Evidenca V.1.2 VKM Nr.436 për kriterin e mesatares; Evidenca V.1.3 VKM Nr.46 i kriterit të mesatares i përditësuar]</p> <p>Kuotat e pranimit të studentëve të ciklit të parë, parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj nga Republika e Kosovës si dhe nga trojet shqiptarë të shteteve të tjerë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparitit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të</p>

<p>studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeseshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>pjeseshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> <p>Pranimi i studentëve realizohet sipas sistemit meritë-preferencë, ku programet e studimit të ofruara nga UGJ, u bëhen të ditura paraprakisht kandidatëve për studentë në portalin e maturës shtetërore. Gjithashtu, në portal publikohen edhe kriteret e pranimit, të përcaktuara për secilin program studimi.</p> <p>Në Rregulloren e UGJ-së, Rregulloren e studimeve në UGJ, Rregulloren e FSHN-së, Rregulloren e DMIF-së përshkruhen kriteret e pranimit dhe përzgjedhjes, ecuria akademike, procesi i transferimit dhe kriteret dhe procedurat e diplomimit.</p> <p><b>[Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë; Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Kreu IV, Kreu V, Kreu VI, Kreu VII; Evidenca I.7 Rregullore e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, Kreu IV, Kreu V, Kreu VI, Kreu VII]</b></p> <p>Informacioni mundësohet nëpërmjet faqes zyrtare ueb të Universitetit [<a href="http://www.uogj.edu.al">www.uogj.edu.al</a>], sekretarisë mësimore të FSHN-së, sistemit të sekretarisë mësimore [<a href="https://uogj.pitagora.rash.al/login">https://uogj.pitagora.rash.al/login</a>] si dhe shpalljeve në standat e njoftimeve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, UGJ informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programeve të studimit. UGJ nëpërmjet zyrës së Alumnit, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, në bashkëpunim me Fakultetet e tij, përfshirë Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe DMIF, realizojnë komunikimin me publikun e interesuar për ndjekjen e programeve të studimit, nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Publikimit në faqen ueb të UGJ të informacioneve rreth programeve të studimit, përmbajtjes së tyre, diplomave që ofron dhe mundësive të punësimit, kriterëve të përgjithshme e të veçanta për ndjekjen e tyre etj.</li> <li>- Organizimit të takimeve promovuese, me nxënës maturantë të shkollave të mesme.</li> <li>- Informimit nëpërmjet rrjeteve sociale.</li> <li>- Informimit nëpërmjet mediave lokale.</li> <li>- Informimit nëpërmjet fletëpalosjeve dhe posterave</li> </ul> <p><b>[Evidenca V.2.1 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024; Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panair Ëork and Study 2022, Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022; Evidenca V.4 Kalendarin e zhvillimit të ditëve të informimit të maturantëve; Evidenca V.4.1 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e ditëve të informimit të maturantëve; Evidenca V.4.2 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e Open Day për informimin e maturantëve; Evidenca V.4.3 Fletëpalosje UGJ; Evidenca V.4.4 Poster UGJ; <a href="http://uogj.edu.al">http://uogj.edu.al</a>]</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>UGJ parashikon kuota dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara si dhe zbaton udhëzimet përkatëse për aplikimin dhe regjistrimin e tyre.</p> <p><b>[Evidenca V.2 Kuotat e pranimit viti akademik 2023 - 2024; Evidenca V.2.1 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024; Evidenca V.1 Udhëzim Nr.12 datë 30.6.2023 Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në IAL]</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>UGJ parashikon kuota dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtetet e tjera dhe kryesisht nga Republika e Kosovës si dhe nga shtetet shqipfolëse të shteteve të tjera si Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë (Serbi) dhe të Huaj.</p> <p><b>[Evidenca V.2 Kuotat e pranimit viti akademik 2023 - 2024; Evidenca V.2.1 Kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024; Evidenca V.1 Udhëzim Nr.12 datë 30.6.2023 Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në IAL]</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në</p>	<p>Nëpërmjet vendimarrjeve dhe procedurave përkatëse institucionale, UGJ implementon politikat e saj të ndihmës/bursave për shtresat në nevojë si dhe për</p>

nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	rritjen e cilësisë së pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. [Evidenca II.14 Vendime Bordi i Administrimit për bursat dhe mbështetje për kategoritë e veçanta; Evidenca II.14.1 Kategoritë e veçanta që përjashtohen nga tarifat 2019-2020; Evidenca II.14.2 Lista e studentëve me aftësi të kufizuara; Evidenca II.14.4 Vendim Senati Akademik për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë; Evidenca II.14.5 Vendim Bordi i Administrimit për heqjen e tarifës në programet e mësuesisë]			
Shkalla e përmbushjes së standartit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	UGJ informon në mënyrë të plotë dhe të hollësishëm studentët që në vitin e parë të studimeve të tyre, në lidhje me procedurat e përparimit akademik dhe kalimin nga një vit në tjetrin. Me fillimin e viti akademik, studentët marrin informacione të rëndësishme, në lidhje me procesin mësimor, planin mesimor, strukturën mësimore, orarin mësimor, pedagogun e lëndës, të publikara në ambjentet e FSHN-së si dhe në faqen zyrtare ueb të UGJ-së. [https://uogj.edu.al/] Në fillim të çdo semestri pedagogët ju prezantojnë studentëve programet lëndore(syllabuset), procedurat për përparimin akademik, detyrimet mbi frekuentimin e lëndës, format e kontrollit të dijeve të fituara dhe vlerësimin të studentëve etj. Informacionet në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit në tjetrin janë të përshkruara hollësisht në Rregulloret institucionale. [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu VI, VII; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Kreu III, IV, V, VI, VII, VIII; Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Kreu V, VI, VII; Evidenca I.7 Rregullore e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, Kreu V, VI, VII].
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	UGJ informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, njohjes dhe transferimit të krediteve midis programeve të të njëjtit cikël studimi, dhe në fusha studimi të njëjta ose të përafërta, në fillim të vitit akademik, brenda UGJ-së dhe në institucione të tjera të arsimit të lartë sipas përcaktimeve në Statutin e UGJ-së [Evidenca I.1 Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, Neni 72] dhe Rregulloreve institucionale [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 65; Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Nenet 29, 30; Evidenca I.7 Rregullore e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, Nenet 26, 27] Informacion më i detajuar, sidomos në lidhje me dokumentacionin e nevojshëm, merret pranë sekretarisë mësimore dhe nëpërmjet shpalljes së njoftimeve në standart të informimit në UGJ. Procedura e njohjes dhe ekuivalentimit të lëndëve mësimore nga programi i mëparshëm i studimit në programin e studimit në UGJ kryhet nga Komisioni i njohjeve dhe ekuivalentimit të lëndëve mësimore i ngritur pranë DMIF-së. [Evidenca V.5 Ekuivalentim lëndesh mësimore Matematikë Informatikë; Evidenca II.20 Procedurë e transferimit të studentëve]

Adresa: Rruga "Studenti"  
Lagja "18 Shtatori", Gjirokastrë 6001  
Tel:+355 84263408

E-mail: rektor@uogj.edu.al

Web site: www.uogj.edu.al

	Gjithashtu, DMIF kryen procedura njohjeje në lidhje me periudha studimi, që studentët e DMIF-së realizojnë në kuadër të programeve të shkëmbimit (mobiliteteve) Erasmus+. [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 92, pika 2; Evidenca V.5.1 Njohje e krediteve nga mobilitetet Erasmus+]
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit	Bazuar në Rregulloret institucionale [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Kreu VI, VII; Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Kreu III, IV, V, VI, VII, VIII; Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Kreu V, VI, VII; Evidenca I.7 Rregullore e Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, Kreu V, VI, VII], DMIF informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre në programin e studimit., duke përfshirë sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit, format e kontrollit të dijeve, kushtet për hyrjen në provim, sezonet e provimeve, organizimin e provimeve, komisionet e provimeve, zhvillimin e provimeve, shpalljen e rezultateve, ankimimin dhe përmirësimin e notës. Ky informacion u bëhet me dije studentëve në fillim si dhe gjatë vitit akademik.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Mbështetur në Kreun VIII Diplomimi, të Rregullores së Studimeve në UGJ, [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Nenet 59, 60, 61, 62, 63, dhe 64], në Rregulloren e UGJ-së [Evidenca I.2 Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 93] në Kreun VII Diplomimi, të Rregullores së FSHN-së [Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Nenet 38, 39] në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” [Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Matematikë Informatikë, Neni 11], si dhe planin mësimor të programit të studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” [Evidenca II.9.1 Plan mësimor Bachelor në Matematikë Informatikë 2021-2022], studentët në programin e studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome. Në rregulloren e studimeve në UGJ, Rregulloren e FSHN-së dhe Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Matematikë Informatikë” përcaktohet qartë pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për të përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome. [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 59, pika 3; Evidenca I.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Neni 38, pika 2; Evidenca I.9 Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Matematikë Informatikë, Neni 11, pika b]. DMIF asiston studentët, duke vënë në dispozicion të tyre informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të punimit të diplomës ose të provimit të përgjithshëm përfundimtar. DMIF, në fillim të vitit të fundit të studimeve përcakton fushat e studimeve për punimin e diplomës [Evidenca III.11.1. Miratimi i fushave të studimit]. Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit duke vendosur afatet e përafërta të realizimit të tij, përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Para mbrojtjes së tezës së diplomës udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe lejon mbrojtjen e punimit duke firmosur tezën e diplomës. Punimi i diplomës bëhet duke mbajtur në konsideratë udhëzimet në Manualin e punimit të diplomës, sipas shtojcës bashkëngjitur Rregullores së studimeve në UGJ [Evidenca I.4 Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, Neni 61; Evidenca III.11.2. Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve]. Studentët të cilët diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar asistohen nga DMIF, duke ju vënë në dispozicion të tyre Programin e provimit të përgjithshëm përfundimtar. [Evidenca III.11. Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar Bachelor në “Matematikë Informatikë”]
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në	Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, UGJ organizon takime të hapura dhe publikon udhëzues të posaçëm për informimin e të interesuarve e studentëve të



mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	ardhshëm mbi programet e studimit në UGJ. UGJ informon gjithashtu edhe nëpërmjet spoteve televizive dhe fletëpalosjeve promovuese në lidhje me programet e studimit që ofron. [Evidenca V.14 Udhërrëfyesi i studentëve; Evidenca II.15 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2022, Evidenca II.15.1 Pjesëmarrje në Panairin Work and Study 2023; Evidenca V.4 Kalendar i zhvillimit të ditëve të informimit të maturantëve; Evidenca V.4.1 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e ditëve të informimit të maturantë; Evidenca V.4.2 Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e Open Day për informimin e maturantëve Evidenca V.4.3 Fletëpalosje UGJ; Evidenca V.4.4 Poster UGJ]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
